



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raporti Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Has”

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR”
TË USHTRUAR NË BASHKINË HAS

Tiranë 2024

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale
AK	Autoritet Kontraktor
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PF	Pasqyrat Financiare
PMNZSH	Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtim
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
UP	Urdhër Prokurimi
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

		PËRMBAJTJA	Faqe
SHKURTIME			2-2
I		PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-9
	1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	4-5
	2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-7
	3	Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	8-9
II.		HYRJA	10-14
	1	Objektivat e auditimit dhe Qëllimi i auditimit	9-10
	2	Identifikimi i çështjes	10-10
	3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10-11
	4	Përgjegjësitë e audituesve	11-11
	5	Kriteret e vlerësimit	11-13
	6	Standardet e auditimit	13-13
	7	Metodat e auditimit	13-14
	8	Dokumentimi i auditimit	14-14
III.		PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14-92
	1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	14-15
	2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejttimeve të auditimit	15-85
	2.1.1	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm	15-20
	2.1.2	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm	20-25
	2.2.1	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	25-32
	2.2.6	Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave	32-38
	2.3	Vlerësimi Raportimit Financiar	38-55
	2.3.4	Mbi administrimin e aseteve, procedurat e inventarizimit e regjistrimit	55-62
	2.7	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	62-77
IV.		GJETJET DHE REKOMANDIMET	77-89
V.		ANEKSE	90-92

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia e **Hasit** është njësi vendore institucion i pavaruar, ku pas ndarjes së re territoriale është një bashkim mes qytetit dhe katër ish-komunave në afërsitë të tij, pra në total ka 4 njësi administrative si vijon: njësia administrative Has (qyteti), njësitë administrative Golaj, Krumë, Fajza, Gjinaj. Bashkia Has kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Krumës. Sipas Censurit të vitit 2011, Hasi ka një popullsi prej 16,790 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, ka 21,247 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 399.62 km² me një densitet prej 53.16 banorë/km². Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 29 fshatra. Pasuritë nëntokësore të këtij rajoni kanë nisur të shfrytëzohen në vitet '30 nga italianët. Deri në mesin e viteve '90 ka funksionuar miniera dhe fabrika e pasurimit të bakrit në Golaj, 6 kilometra larg qytetit të Krumës si dhe disa miniera më të vogla, ku ishin të punësuar mbi 3000 punëtorë. Jo vetëm banorët, por edhe specialistët thonë se nëntoka ende nuk është prekur. Për mineralin e bakrit dallohen zona Nikoliq Golaj, Krumë dhe Zahrisht në rrethin e Hasit. Relievi i zonës shtrihet nga rreth 300 metra mbi nivelin e detit deri në malet e larta të Gajrepit, Pashtrikut dhe Maja e Kunorës, të cilat gjenden në lartësitë 1400-1900 metra mbi nivelin e detit.

Misioni i Bashkisë Has është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Buxheti i Bashkisë Has si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavaruar, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nenit 50 "Auditi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "*1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*". Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Has si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, përperiudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Has. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi raportimin financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023 janë hartuar dhe paraqesin informacion kontabël në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.
- mbi procedurat e transferimit dhe rregjistrimit të pronave të palujtshme bashkisë dhe menaxhimin e tyre.
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 15 gjetje dhe ka dhënë 16 rekomandime, nga ku masa organizative me 11 gjetje dhe 11 rekomandime, 4 gjetje dhe 5 rekomandime në vlerën 388,013,959 lekë në fushën e të ardhurave si masa për uljen e borxhit tatimore dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ Mbi Menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe funksionimin e NJAB

Bashkia Has nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim pasi u konstatuan se:

- Nuk është hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre,
- Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) nuk ka kryer funksionet e veta.
- Nuk disponon përshkrime pune, dhe procedura e ndjekur për hartimin e tyre nuk është bërë në përputhje me dispozitat ligjore
- Nuk ka hartuar një strategji risku, nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk.
- Nuk është miratuar gjurma e auditimit.
- Njësia e Auditit të Brendshëm për vitin 2023 nuk ka funksionuar në mënyrë të plotë për arsye se strukturuar është plotësuar vetëm me 1 auditues dhe jo 3 auditues sic përcaktojnë dispozitat ligjore.
- Plani i angazhimeve të auditimit është realizuar në masën 50% dhe dosjet e auditimit janë të mangëta dhe të pa inventarizuara.

▪ Mbi mbi raportimin financiar dhe kontabilizimin e transaksionet financiare

- Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në fund të vitit 2023 , rezulton në vlerë neto 1,791,490 lekë dhe vlerë historike 9,729,027 lekë, që i përket 27 projekt-studimeve për investime të kryera në vitet e mëparshme, vlerë e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar.

- Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Sektori i Financës i mungon libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera nga ditarët deri në bilanc. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël, çka tregon se veprimet me llogaritë nuk kanë ndjekur rrjedhën logjike kontabël për nxjerrjen e bilancit.

- Gjendja e llogarisë 423-429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën prej 914,949 lekë. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson

- Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 28,103,657 lekë, vlerë kjo, e cila nuk rakordon me shumën e gjendjeve të llogarisë analoge 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” në vlerën 28,103,657 lekë dhe llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” në vlerën 11,333,144 lekë të bilancit, ndërkohë që detyrimi i plotë, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara në fakt në fund të vitit 2022 është 39,436,801 lekë.

- Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në fund të vitit 2023 në llogaritë: 210 “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 1,074,183 lekë; 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 966,447,807 lekë; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 1,627,644,078 lekë; 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 75,859,409 lekë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2023 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për vitin 2023 nuk është kryer inventari fizik i aktiveve materiale dhe jo materiale si dhe aktiveve afatshkurtra të Bashkisë Has dhe 4 NJA-ve, Për këto aktive nuk është kryer inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre.

▪ ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave***

- Të ardhura të munguara në vlerën 44,002,268 lekë nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit, institucioneve dhe familjarë.

- Nuk aplikohet dhe nuk arkëtohet taksa e tokës nga fermerët.

- Të ardhura të munguara në vlerën 12,043,113 lekë nga mosarkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 266 debitorë.

- Të ardhura të munguara në vlerën 4,447,000 lekë nga mosarkëtimi i tarifës së autorizimit për ushtrim aktiviteti tregtimi hidrokarbure dhe derivatet e tyre nga 9 subjekte.

- Të ardhura të munguara nga mosarkëtimi i tarifës së qirasë në vlerën 1,207,336 lekë nga 10 subjekte qiramarrës të parcelave pyjore dhe parcelave të tokave të pandara në kundërshtim me kontratat e qidhenies së aseteve pronë ose në përdorim të Bashkisë Has.

▪ ***Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe rregjistrimin e aseteve***

Nga auditimi rezultoi se, janë 1444 prona të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Has (Qendër), listat përfundimtare të të cilave janë të miratuara me VKM-ët përkatëse, ndërsa për 412 prona të 3 Njësive Administrative si **Golaj e Fajza** janë në fazën e miratimit të listave paraprake dhe **Gjinaj** në fazën fillestare. Nga këto prona janë hipotekuar 20 pasuri të paluajtshme dhe janë në proces aplikimi për certifikim hipotekor 26 pasuri të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë përditësimi i të dhënave të inventarit të këtyre pronave. Në mungesë të inventarizimit, përditësimit dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në

lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Has në lidhje me *menaxhimin financiar dhe kontrollin* të marrë të gjitha masat për hartimin dhe miratimin e strategjisë së riskut. Titullari i Bashkisë Has të miratojë gjurmën e auditimit për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë. Koordinator i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën të informacioneve cilësore për vlerësimin e progresit të bërë nga njësia në arritjen e objektivave të MFK-së. Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has të marrin masat për hartimin e planit vjetor të trajnimeve të punonjësve.

- Bashkia Has në lidhje me *organizimin dhe funksionimin e NJAB* të marrë të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm me punonjësit e nevojshëm me qëllim bërjen funksionale të kësaj njësie auditimi për përmbushjen e misionit të saj, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë.

- Bashkia Has *në lidhje me të ardhurat*, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 44,002,268 lekë nga taksapaguesit të biznesit, institucione shtetërore, familjarë, fermerë, individë etj, vlerën prej 12,043,113 lekë të taksës në infrastrukturë për legalizimet, si dhe vlerën prej 1,207,337 lekë të tarifës së qirasë nga qiramarrësit e aseteve në pronë/përdorim të Bashkisë.

- Bashkia Has në lidhje me *raportimin financiar nëpërmjet rregullsisë së hartimit të pasqyrave financiare* të marrin masa për kryerjen e procedurave të inventarizimit fizik të aktiveve të paktën një herë në vit, si dhe të kryhen përditësimet në kontabilitet duke plotësuar dhe saktësuar regjistrin historik të aktiveve; Të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës 1,791,490 lekë të gjendjes së llog. 202 “*Studime dhe Kërkime*”; Të analizojë dhe të përcaktojë të drejtat e konstatuara për arkëtim në vlerën 914,949 lekë, gjendje e llog. 423-429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*”; Të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare, duke ndjekur fazat në mënyrë llogjike, që nga mbajtja e dokumentave përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve, që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik.

- Në lidhje me *inventarizimin, përditësimin dhe rregjistrimin e aseteve në ASHK* Bashkia Has nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për miratimin e listave përfundimtare të pronave për 3 NJA Golaj, Fajza dhe Gjinaj, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave të paraprake apo fillestare të pronave të miratuara. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim, të pa hipotekuar të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Vendore Has.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Opinioni i auditimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Has për vitin ushtrimor 2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare,

ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

*Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një **opinion të modifikuar/kualifikuar me rezervë** për llogaritë vjetore të Bashkisë Has, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitin 2023, të shprehura në bazën për opinion.*

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit”, pjesë e Raportit të auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit të përlllogaritur 6,233 mijë lekë dhe nivelin e gabimit të lejuar 623 mijë lekë.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese për pasqyrat financiare të vitit 2023 janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të modifikuar me rezervë, ku ka rezultuar se anomalitë janë materiale, por jo të përhapura sipas përshkrimit të çështjeve të mëposhtme:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të **opinionit të modifikuar /kualifikuar me rezervë**, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

- Gjendja e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” në fund të vitit 2023 , rezulton në vlerë neto 1,791,490 lekë dhe vlerë historike 9,729,027 lekë, që i përket 27 projekt-studimeve për investime të kryera në vitet e mëparshme, vlerë e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar.

- Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Sektori i Financës i mungon libri i madh apo libri centralizatori për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera nga ditarët deri në bilanc. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël, çka tregon se veprimet me llogaritë nuk kanë ndjekur rrjedhën logjike kontabël për nxjerrjen e bilancit.

- Gjendja e llogarisë 423-429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën prej 914,949 lekë. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën prej 18,586,594 lekë, vlerë e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë analoge 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” në vlerën 19,759,878 lekë të aktivitetit të bilancit, pasi kjo gjendje duhet të pasqyrohet detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

- Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në fund të vitit 2023 në llogaritë: 210 “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 1,074,183 lekë; 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 966,447,807 lekë; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në vlerën 1,627,644,078 lekë; 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 75,859,409 lekë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2023 për të gjithë aktivitetet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për vitin 2023 nuk është kryer inventari fizik i aktiveve materiale dhe jo materiale si dhe aktiveve afatshkurtra të Bashkisë Has dhe 4 NJA-ve, Për këto aktive nuk është kryer inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre.

- Referuar analizës së llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” dhe lëvizjeve shtesa-pakësime nga viti 2022 në vitin 2023 konstatohet se, vlera e shtuar e debitorëve në vitin 2023 për taksën e infrastrukturës prej 1,729,423 lekë nuk është përfshirë në gjendjen e kësaj llogarie në mbyllje të vitit 2023.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot. 359/1, datë 13.03.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 18.03.2024 deri në datë 12.04.2024, në subjektin Bashkia Has për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 u krye auditimi “Mbi auditimin Financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. M. K. – *Përgjegjës Grupi*
2. E. K. – *Audituese*
3. I. Sh. – *Audituese*
4. G. P. - *Auditues*

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar në Bashkinë Has ka si objektiva kryesor:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Has është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme për periudhën nën auditim viti 2023, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Has dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

Pika 1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

Pika 2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

Pika 3. Vlerësimi i raportimit financiar.

Pika 4. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Pika 5. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Has, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;

- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).

- fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Has, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6.Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Has është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Has. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;

- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;

- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;

- Ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;

- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;

- VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendor”;

- V.K.M Nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;

- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të

ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;

-VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;

- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;

- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar

- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;

- Udhëzimi MF nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;

- Udhëzimin e MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;

- Udhëzimin e MF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”;

- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.05 datë 21.02.2022;

- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;

-Udhëzim i KM nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”;

-Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik i miratuar me urdhrin e Ministrit të MFE nr. 100, dt. 16.10.2017.

- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike

▪ *Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;*

▪ *Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;*

▪ *Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.*

▪ *Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;*

▪ *Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.*

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Has grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 200; 400 etj “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

-Manuali i zbatimit të rekomandimeve të KLSH.

-Manuali i auditimit financiar të KLSH me ndryshime.

8. Metodatat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me

nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pështja specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, me metodat si më poshtë: *Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimeve, Konfirmimi nga të tretët, Kontrolli sipas një treguesi, Intervista, Raporte dhe Informacione, Praktikant e ndjekura në kryerjen e auditimit.*

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja².

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe

² Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akt-Konstatimeve dhe Akt-Verifikimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Projekt raport Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Has

1. Informacioni i Përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Has u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në drejtim të raportimit financiar, të menaxhimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, menaxhimin, inventarizimin dhe hipotekimin e pronave/aseteve.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin dhe realizimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektivit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave për shpenzimet dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Zona Gjeografike: Bashkia Has kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Krumës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 16,790 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil ajo numëron një popullsi prej 21,807 banorë. Bashkia e Hasit ka një sipërfaqe prej 399.62 km².

Historik i zhvillimit ekonomik: Bashkia Has përbëhet nga 4 Njësi Administrative. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 29 fshatra. Pasuritë nëntokësore të këtij rajoni kanë nisur të shfrytëzohen në vitet '30 nga italianët. Deri në mesin e viteve '90 ka funksionuar miniera dhe fabrika e pasurimit të bakrit në Golaj, 6 kilometra larg qytetit të Krumës si dhe disa miniera më të vogla, ku ishin të punësuar mbi 3000 punëtorë. Jo vetëm banorët, por edhe specialistët thonë se nëntoka ende nuk është prekur. Për mineralin e bakrit dallohen zona Nikoliq Golaj, Krumë dhe Zahrisht në rrethin e Hasit. Relievi i zonës shtrihet nga rreth 300 metra mbi nivelin e detit deri në malet e larta të Gajrepi, Pashtrikut dhe Maja e Kunorës, të cilat gjenden në lartësi të 1400-1900 metra mbi nivelin e detit.

Sfidat me të cilat përballet: Bashkia përballet me një sërë sfidash të rëndësishme janë: Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve; Ndërhyrja në infrastrukturën e rrugëve dytësore të qytetit dhe fshatrave përreth, mirëmbajtja e institucioneve arsimore dhe shëndetësore; Mbështetja dhe nxitja më tej e turizmit, rritja e të ardhurave nëpërmjet politikave fiskale dhe qiradhenies për menaxhimin e mirë të resurseve që ka kjo bashki; Ripërtëritja e jetës kulturore dhe artistike të zonës, por dhe zhvillimi i ambienteve dhe aktiviteteve sportive për rritjen e përfshirjes së të rinjve në jetën sociale të qytetit, etj.

Rendësia e këtij auditimi është sepse, auditimi është pjesë jetike e një sistemi rregullator, që ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur që subjekti i audituar të ndërmarrë veprimet korrigjuese sipas rastit, të rritë përgjegjshmërinë në llogaridhënie, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara, si dhe parandalimin e shkeljeve me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve

II. 1. Auditim mbi kontrollin e Brendshëm financiar publik.

II.1.1 Mbi Identifikimin dhe vlerësimin e nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike për periudhën e aktivitetit viti 2023.

Nga auditimi ka rezultuar se, menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundur dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
- b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Titullarët e njësisë të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësisë të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

- a) ***Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;***

Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se “*Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje*”. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, institucionet duhet të hartojnë kod etike.

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Has disponon Kod Etike i miratuar me nr.05/1 prot. Datë 03.01.2019, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuar të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje. Njëkohësisht nga Bashkia Has është miratuar dhe Kodi i etikës për Audituesit e Brendshëm me nr.975 prot. Datë 12.03.2024.

b) Politikat menaxheriale dhe stili i punës;

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstroi dhe nxit kompetencën dhe sjelljen etike.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në nenin 8, pika 8/a të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave*’. Për sa më sipër rezulton se Bashkia Has nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

Gjithashtu, në nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK, përcaktohet se “*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike*”. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se “*Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrihen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave*”. Grupit të auditimit nuk i është paraqitur urdhri i titullarit në të cilin përcakton ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik, si organ i rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar të njësisë publike dhe në sistemin e kontrollit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të ligjit për MFK. Nga kjo rezulton se për vitin 2023 titullari i Bashkisë Has ka nxjerrë vendimin me nr.prot 42, datë 13.01.2023 për Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA-së 2024-2026, Bashkia Has. Por këtu nuk janë reflektuar ndryshimet e ndollura nga zgjedhjet e pushtetit vendor përgjatë muajit qershor 2023 që ka bërë të ketë lëvizje të punonjësve. Këto ndryshime janë reflektur ne vendimin me

nr.prot 79, datë 08.01.2024 për Ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA-së 2024-2026, Bashkia Has.

Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se “*GMS duhet të mbliidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike*”. Për sa më sipër, për vitin 2023, nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se “*Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësisë të tij, nëpunësi autorizues mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës*”.

c) *Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;*

Bashkia Has e kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme, e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 05 prot, datë 03/01/2019 “*Rregullore e funksionimit të brendshëm administrativ të Bashkisë Has*”.

Për vitin 2023, Bashkia Has ka funksionuar mbi bazën e një rregulloreje.

Bashkia Has nuk disponon përshkrime pune, dhe procedura e ndjekur për hartimin e tyre nuk është bërë në përputhje me nenin 24 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” në të cilin përcaktohet se “*Procesi i vlerësimit të punës ndjek këto faza: a) krijimi i komitetit të vlerësimit; b) identifikimi i pozicionit/ pozicioneve të punës që do të vlerësohen; c) vlerësimi me faktorë dhe pikëzimi sipas metodologjisë së vlerësimit të pozicionit të punës; ç) klasifikimi i pozicionit të punës në kategorinë, klasën dhe grupin përkatës*”. Gjithashtu, këto përshkrime pune nuk janë miratuar nga DAP, sikurse përcaktohet në nenin 35 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 “*Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës shtetërore: a) miraton propozimin për klasifikim të pozicionit/pozicioneve të punës; b) kthen për rivlerësim pozicionin/pozicionet e punës dhe vendos një afat të arsyeshëm për plotësimin e rivlerësimit*”.

ç) *politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;*

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve, sikurse përcaktohet në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” “*Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj. Vlerësimi i rezultateve në punë synon përmirësimin e aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit*”. Gjithashtu, Bashkia Has nuk disponon një program trajnimi për punonjësit por janë dërguar nevojat për trajnim.

2. Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se “*Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka*

ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollin që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit”. Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Has nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296.

*Gjithashtu, ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar ku përcaktohet se “*Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë*”.*

Bashkia Has nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk.

Pavarësisht rëndësisë që ka identifikimi i risqeve dhe menaxhimi i tyre, Bashkia Has nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje. Mungesa e një strategjie risku, e një regjistri risku dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eliminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale.

3. Veprimtaritë e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Mungesa e identifikimit të risqeve, mungesa e një strategjie institucionale në të cilën të jenë përcaktuar objektivat dhe planet e veprimit, si dhe mungesa e qartë e ndarjes së detyrave në Bashkinë Has, vështirësojnë kryerjen efektive të kontroleve, identifikimin e parregullsive dhe nxjerrjen e përgjegjësieve.

Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar përcaktohet se “*Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi*”. Për sa më sipër, rezulton se Titullari i Bashkisë Has për vitin 2023 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

4. Informacioni dhe komunikimi

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv.

Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Has, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Has ka një faqe zyrtare ëeb në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen ëeb Bashkia Has ka programin e transparencës, në zbatim me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ku në nenin 4 përcaktohet se ‘*Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga*

hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim të një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni”. Gjithashtu, Bashkia Has ka edhe regjistrin me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në zbatim me këtë ligj ku në nenin 8 përcaktohet se “Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuësve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër”.

5. Monitorimi

Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Me qëllim monitorimin e institucioneve të varësisë, në nenin 9 pika 3 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, përcaktohet se “Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë”. Për sa më sipër, nuk ka asnjë dokumentim të raportimit mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paraqitet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masa për përmirësime në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në zbatim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Në nenin 18, pika 1, e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se “Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual”.

Për sa më sipër, për periudhën nën auditim, rezulton se Bashkia Has ka plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit e cila i është dërguar Ministrisë së Financave (DHMFK) me shkresën nr. 744/1 prot. Datë 23.02.2024.

Për vitin 2023 rezulton se nëpunësi autorizues i Bashkisë Has ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në zbatim me nenin 18 të ligjit për MFK-në.

Për vitin 2023 nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has nuk është hartuar plani vjetor i trajnimeve në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. L.M në funksionin e ish-Kryetarit të bashkisë Has, z.M. D. në funksionin e Kryetarit aktual të Bashkisë Has, z.F. Th. me detyrë ish zv/Kryetari

i Bashkisë dhe në cilësinë e nëpunësit autorizues, z.P. C. me detyrë ish-Drejtori i Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave dhe në cilësinë e Sekretarit të (GMS)

II.1.2. Mbi Organizimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Has.

II.1.3. Mbi vlerësimin e veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Has.

Nga auditimi i kryer mbi organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) të Bashkisë Has, për periudhën e aktivitetit viti 2023 rezultoi se:

Organizimi dhe Funksionimi : Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e NJAB në sektorin publik” Bashkia Has ka ngritur NJAB. Për **vitin 2023** NJAB ka funksionuar me 1 auditues sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Titullari i Bashkisë me vendimin nr. 95 datë 01.01.2023 “Struktura organizative e miratuar” (e ndryshuar) me VKB nr. 581, datë 22.06.2023 ku struktura e Njesisë së Auditit të Brendshëm është e përbërë nga 1 përgjegjës dhe 2 specialist auditit.

Konkluzion: Për vitin 2023 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1 (auditues), Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme “Për Organizimin e Funksionimin Administratës” së Bashkisë Has të miratuar me VKB nr. Prot. 05, datë 03.01.2019 mbi bazën e të cilës funksionojë të gjitha strukturat e Bashkisë. Ku parashikohen nga neni 90 deri në 93 detyrat e Auditimit të Brendshëm, ku në nenin 90 parashikohet vetëm një specialist auditimi në varësi të kryetarit të Bashkisë.

Sipas VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” pika 3 e cila përcakton se: “Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3(tre) punonjës, përfshirë drejtuesin e njësisë. Në strukturën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të paçertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.”

Në lidhje me këtë është audituar nga KLSH në auditimin e kaluar ku dhe është lënë rekomandimi: Që Bashkia Has të marrë masa për ngritjen e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si dhe një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë ose, shërbimi i auditit të brendshëm të kryhet nga njësia e auditit të brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse.

Në lidhje me këtë nga Bashkia Has është nxjerrë urdhëri me nr.prot. 581 datë 22.06.2023, urdhër ky që ka bërë ndryshime në strukturën e Bashkisë duke vendosur sektorin e auditit të brendshëm me një përgjegjës dhe dy specialistë por aktualisht përbehet vetëm nga një specialist.

Struktura e NJAB, niveli i arsimit, çertifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës se mëposhtme:

Nr	Periudha 2023	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime te vijueshme
1	Harold Brati	Auditues	Ekonomi Finance	2	1	JO	PO

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes të punonjësit të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se ky punonjës është emëruar në datë 01.11.2022 dhe i ka shkeputur marrëdhëniet financiare me Bashkinë Has më datë 23.10.2023. Nga data 23.10.2023 e deri më datë 03.01.2024 Njësia e Auditimit të brendshëm nuk ka patur asnjë punonjës efektiv. Ky auditues rezulton nga auditimi se nuk ka qenë i çertifikuar por ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnime për kualifikimin profesional, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”nenet 11, “Punësimi i Auditit të Brendshëm” neni 19 “Certifikimi i audituesve të brendshëm” dhe neni 20 “Trajnimi i vijueshëm profesional i

audituesve të brendshëm”. Ndërkohë kjo strukturë nga data 03.01.2024 dhe në vazhdim funksionon me një auditues të emëruar znj. E. Z. e diplomuar me arsim të lartë Financë. Ajo që konstatohet nga auditimi është mos plotësimi me punonjësit e kërkuar sipas strukturës së miratuar të NJAB.

➤ **Karten e Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik**

NJAB në mbështetje te Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” nuk ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm ne sektorin publik” në Bashkinë Has për vitin 2023.Nga ana e Bashkisë Has është hartuar e miratuar Karta e Auditimit të Brendshëm me Urdhërin e Kryetarit nr.142 datë 12.03.2024

Nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është hartuar e miratuar nga Bashkia Has Kodi i Etikës për Audituesit e Brendshëm me Urdhërin nr.143 datë 12.03.2024.

➤ **Planet Strategjike dhe Vjetore:**

Ne mbështetje te Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Per vitin 2023 me shkresën nr.2344, datë 01.11.2022 është miratuar plani strategjik për vitet 2023 – 2025 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2023.

Këto plane janë dërguar zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”,me shkresën nr.2344 prot,datë 01.11.2022.

Sipas Planifikimit ka qenë e parashikuar që nga Njësia e AB në Bashkinë Has të mbulohen me auditim 6 subjekte:(Sektori i Burimeve Njerëzore; Njësia Administrative Golaj; Detyrimet e Prapambetura; Sektori Juridik dhe Njësia e Prokurimeve; Sektori i Ndhmës Ekonomike; Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave.), NJAB në hartimin e këtij planifikimi është bazuar duke u fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuara dhe duke marrë në konsideratë edhe respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve.

➤ **Realizimi i Planeve Vjetore:**

- **Për vitin 2023** janë parashikuar gjithsej 6 auditime në Bashki, ku sipas llojit janë të përputhshmërisë, të performancës dhe financiar. Ky plan nuk ka patur ndryshime. Realizimi i misioneve të auditimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financë	Kombinuar	Performancë	Tjera
1	Viti 2023	6	3	2	1			

Raportimi : Në lidhje me këtë periudhë auditimi të veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është realizuar ndonje vlerësim i jashtëm i cilësisë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Nga kjo strukture është kërkuar Raporti i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 me shkresën nr.1050 prot. Datë 06.02.2024 drejtuar Bashkisë Has.

Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkinë Has për periudhën objekt auditimi, është raportuar duke u hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportin vjetor të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për

veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr.531/1 prot, datë 13.02.2024 “Dërgim Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB”. Të dhënat rezultojn se nga AB për vitin 2023 janë realizuar 3 auditime nga 6 angazhime auditimi të planifikuara, pra në masën 50% ,sipas tabelës së mëposhtme:për auditimet e kryera paraqiten në tabelat e mëposhtme:

r	Subjektet e Audituar	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Statusi i Angazhimit		
		Gjithsëj	Auditime të realizuara sipas llojit të tyre					Angazhimet të përfunduar	Angazhime në proces
			Shërbime të Sigurisë nga të cilat:						
			A. të përputhshme	A. të performancë	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara		
1	Drejtoria e Financave, Taksave dhe Tarifave	1			1		1		
2	Njësitë Administrative Golaj, Fajza dhe Gjinaj	1	1				1		
3	Sektori i Burimeve Njerëzore	1	1				1		

➤ Gjetje-Rekomandimet

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i aktivitetit auditues është dhënia e rekomandimeve në përfundim të auditimeve, ku:

Për vitin 2023 Nga auditimet janë evidentuar 9 gjetje, për të cilat janë dhënë 10 rekomandime.

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dem)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
4	Viti 2023	10		10					
TOTALI		10		10					

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të A.B. Nga auditimi rezultojn se nga NJAB nuk janë dërguar shkresa njëjësive të audituara për të kërkuar informacion mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna dhe në auditimin e radhës çështja e zbatimit të rekomandimeve duhet të trajtohet si çështje kryesore. Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2023	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT			
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimit të sistemeve	Rekomandime të përmirësimit të kuadrit ligjor	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime
1.	Drejtoria e Financave, Taksave dhe Tarifave	2		2		2			2	
2.	Njësitë Administrative Golaj, Fajza dhe Gjinaj	3		3		3	1		2	
3	Sektori i Burimeve Njerëzore	5		5		5	2		3	

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve rezultojn se nga kjo Njësi AB nuk dokumentohen treguesit e masave të rekomanduara si përsa i përket pranimit nga subjektet të cilave i janë adresuar ashtu dhe për statusin e gjendjes së tyre. Kjo dhe për faktin e mos funksionimit të kësaj njësie nga datë 23.10.2023 deri në fund të vitit 2023.

Në lidhje me tre misionet e përfunduara nga kjo Njësi Auditimi konstatohet se ato janë jo dosje të plota e të inventarizuara por vetëm programet e angazhimit të auditimit; Autorizimet për

fillimin dhe përgatitjen e angazhimit; njoftimin për fillimin e angazhimit si dhe Raporti përfundimtar i auditimit që në të tre rastet është i pa nënshkruar nga Audituesi H. B.

Kjo dhe për faktin e largimit nga detyra të Audituesit pa dorëzuar detyrën.

Nga auditimi rezulton se: Veprimtaria e Njesisë së Auditit të brendëshëm të Bashkisë Has për periudhën e auditimit viti 2023 duke qenë në kushtet e gjëndjes së trajtuar si më sipër në këtë akt konstatim është në kundërshtim dhe në mos përmbushje si të misionit e të rolit të tijë konform kërkesave të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Auditimin në Sektorin Publik” në nenet 2;5 dhe 6

Veprimtaria e NjAB rregullohet nëpërmjet detyrave të drejtave e përgjegjësisve të përcaktuara në legjislacion dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tijë. E konkretisht në Ligjin Nr. 114/2015 “Për Auditimin në Sektorin Publik” ndër të tjera në nenet 12; 14 dhe 16 të të cilit citohen përgjegjësitë si të titullarëve të NJAB të Drejtuesit të Njesisë AB si dhe të audituesve të kësaj njësie.

Konkluzion: Si përfundim konstatohet se: Veprimtaria e Njesisë së Auditimit të Brendëshëm është në mos përputhje të plotë me kuadrin rregullator dhe me standartet ndërkombëtare për praktikatat profesionale të auditimit të brendshëm” duke qenë në kushtet kur kjo strukturë ka funksionuar me një auditues (si trajtuar mësipër) dhe njëkohësisht pa eksperiencën e nevojshme. Për këtë periudhë auditimi viti 2023 mban përgjegjësi, ish Titullari dhe Titullari aktual i Bashkisë Has dhe ish Audituesi i kësaj Njesisë z. H. B.

2. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 993, datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2022, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:

- PBA 2023-2025;
- Projekt-buxhetin e miratuar për vitin 2023;
- Vendimet e KB “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Has” për vitin 2023;
- Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve për vitin 2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Situacioni i të ardhurave për vitin 2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të Bashkisë Has;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

Baza Ligjore:

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 115/2021, datë 24.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore”.

- Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025";
- VKB nr. 96, datë 22.12.2022, "Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2023 dhe PBA vitit 2023-2025", konfirmuar e Prefektit të Qarkut Kukës me shkresë nr. 3/60, datë 09.01.2023.

1. Programimi i PBA-së 2023-2025

Për hartimin e PBA-së 2023-2025 nga Bashkia Has janë ndjekur dhe zbatuar hapat e më poshtëm:

- VKB nr. 96, datë 22.12.2022, "Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2023 dhe PBA vitit 2023-2025";
- VKB nr. 23, datë 30.03.2022, "Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të buxhetit afatmesëm 2023-2025";
- Dërgimi i miratimit të draftit projekt dokumentit të PBA 2023-2025 me shkresën nr. 1215 prot., datë 31.05.2022 në MFE;
- Dërgimi i PBA i rishikuar 2023-2025, me shkresën nr. 1973, datë 14.09.2022 në MFE;
- VKB nr. 49, datë 29.07.2022, "Për tavanet përfundimtare të shpenzimeve të buxhetit afatmesëm 2023-2025";
- VKB nr 81, datë 22.12.2021, "Për miratimin e kalendarit orientues për menaxhimin e shpenzimeve vendore gjatë vitit 2022, Bashkia Has, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025".

Nga auditimi konstatohet se,

1. Për hartimin e PBA-së për periudhën 2023-2025, rezulton se nga strukturat e Bashkisë Has nuk janë marrë masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, brenda datës 5 korrik në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025", kreu I, pika 15;
2. Kryetari i Bashkisë Has nuk ka miratuar udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025", kreu I, pika 5 dhe 6.

Tabela nr. II.1.1: Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	50,072	16.4%	61,386	21.3%	58,718	19.7%
2	Shërbimet e Policisë Vendore	6,720	2.2%	8,900	3.1%	7,900	2.7%
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	26,126	8.6%	22,100	7.7%	22,573	7.6%
4	Shërbimet Bujqësore, inspektimi, ushqimi	4,810	1.6%	5,030	1.7%	5,100	1.7%
5	Menaxhimi I Infrastruktūrës se ujitjes dhe kullimit	12,445	4.1%	8,100	2.8%	12,700	4.3%
6	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	18,426	6.0%	21,800	7.6%	22,300	7.5%
7	Rrjeti rrugor rural	32,189	10.6%	29,500	10.3%	31,000	10.4%
8	Menaxhimi i Mbetjeve	14,315	4.7%	4,200	1.5%	6,800	2.3%
9	Planifikimi Urban dhe Vendor	3,970	1.3%	2,000	0.7%	2,500	0.8%
10	Shërbimet publike vendore	47,945	15.7%	45,651	15.9%	48,318	16.2%
11	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	4,770	1.6%	4,600	1.6%	5,000	1.7%
12	Sport dhe argëtim	2,330	0.8%	2,800	1.0%	3,000	1.0%
13	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	3,840	1.3%	4,000	1.4%	4,395	1.5%
14	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	49,590	16.3%	46,404	16.1%	46,103	15.5%
15	Arsimi Mesëm i Përgjithshëm	16,580	5.4%	11,300	3.9%	11,600	3.9%

16	Përkujdesi social	10,188	3.3%	9,500	3.3%	9,500	3.2%
17	Strehimi Social	300	0.1%	300	0.1%	300	0.1%
TOTALI		304,616		287,571		297,807	

Burimi: Bashkia Has

Tabela nr. II.1.2: Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2023-2025

Nr	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	174,529	57%	175,529	61%	176,529	59%
2	Sigurime (601)	26,225	9%	26,071	9%	25,737	9%
3	Shpenzime operative (602)	75,517	25%	65,887	23%	74,226	25%
4	Shpenzime (603)						
5	Shpenzime (604)						
6	Shpenzime (606)	3,632	1%	7,384	3%	7,547	3%
7	Shpenzime (609)						
8	Shpenzime për investime (230-231)	24,713	8%	12,700	4%	13,768	5%
Total		304,616		287,571		297,807	

Burimi: Bashkia Has

Tabela nr. II.1.3: PBA 2023-2025 tendenca e të ardhurave, në mijë lekë

A	Të ardhurat	2023	2024	2025
1	Nga taksat	35,311	31,565	32,899
2	Jo tatimore			
I	Totali	35,311	31,565	32,899
1	Transferta e pakushtëzuar	171,207	171,207	180,059
2	Transfertë specifike	98,098	84,799	84,849
	Tjera...			
II	Shuma e transfertave	269,305	256,006	264,908
III	Transferta te pritshme (FZHR e tjera)	-	-	-
	Totali i burimeve të veta (I +II+III)	304,616	287,571	297,807

Burimi: Bashkia Has

2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura

Për vitin 2023 në Bashkinë Has buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 10 programeve, përkatësisht: Shërbime të Përgjithshme Publike, Rendi dhe Siguria Publike, Çështje Ekonomike, Mbrojtja e Mjedisit, Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit, Shëndetësia, Argëtimi, Kultura dhe Feja, Arsimi dhe Mbrojtja Sociale.

Rezulton se buxheti i viteve 2023-2025 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

Tabela nr. II.2.1: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2023

Planifikimi i të ardhurave 2023		Planifikimi i shpenzimeve 2023	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	35,311	Art. 600 Paga	171,331
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm	6,574	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	29,423
Total të ardhurat e veta	41,885	Art.602 Shpenzime operative	74,662
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.	471	Art.604 Transferime korrente të brendshme	-
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëz (transfe specifik 600, 601, 602 etj.).	-	606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë	6,400
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2023	171,207	Art.230-231 Investime	26,213
Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2023	98,097	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	3,632
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit të shtetit	269,775		
TOTALI TË ARDHURAVE	311,660	TOTALI SHPENZIMEVE	311,660

Burimi: Bashkia Has

Tabela nr. II.2.2: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2023

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2023			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB	Vlera në 000/lekë	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB	Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	35,311	4,980	40,291	Art. 600 Paga	174,529	11,042	185,571
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2023	6,574		6,574	Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	28,525	1,860	30,385
Total të ardhurat e veta	41,885	4,980	46,865	Art. 602 Shpenzime operative	73,217	14,271	87,488
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	471		471	Art. 604 Transferime korrente të brendshme		3,394	3,394
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike				Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë		359,781	359,781
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2023	269,305	40,773	310,078	Art. 230-231 Investime	24,713	105,893	130,606
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2023		440,283	440,283	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	3,632	-3,632	0
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit	269,775	481,056	750,832				
TOTALI TË ARDHURAVE	311,660	486,036	797,697	TOTALI I SHPENZIMEVE	304,616	492,609	797,225

Burimi: Bashkia Has

➤ **Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023**

Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **797,255** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **751,336** mijë lekë, ose në masën **94%**. Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr. II.2.3: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Has për vitin 2023, në mijë lekë						
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve Bashkia pa njësitë vartëse	Plani 2023	Fakti 2023	Realizimi në %	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta (fakti)	Vlera e mbuluar nga granti (fakti)
1	Artikulli - 600 Paga	185,571	182,445	98%	2,284	180,161
2	Artikulli - 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	30,385	29,254	96%		29,254
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	87,489	80,051	91%	7,587	72,464
4	Artikulli - 604 Transferta korrente të brendshme	3,393	3,393	100%	384	3,009
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (PAK)	359,729	353,539	98%	1,372	352,282
6	Artikulli - 230 Projekte					
7	Artikulli - 231 Investime	130,606	102,539	79%	18,549	83,990
8	Artikulli 609 (fond rezervë + kontigjencës)	52	0	0%		
	TOTAL	797,225	751,336	94%	30,176	721,160

Burimi: Bashkia Has

VKB nr. 96, datë 22.12.2022, “Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2023 dhe PBA vitit 2023-2025”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut.

Nga bashkia ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve

të grandeve. Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, me VKB nr. 08, datë 31.01.2023, datë 31.01.2023, “Një shtesë në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2023” (të ardhura të trashëguara), VKB nr. 24, datë 31.03.2023, “Dhënie fondi nga buxheti i Bashkisë Has për disa familje në nevojë për vitin 2023”, VKB nr. 23, datë 31.03.2023, “Një shtesë në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2023”, VKB nr. 8, datë 24.07.2023, “Shtesë dhe rishpërndarje në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2023”, VKB nr. 16, datë 18.09.2023, Një shtesë në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2023”, VKB nr. 29, datë 14.11.2023, “Një shtesë në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2023”, VKB nr. 36, datë 22.12.2023, “Një shtesë në buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2023” dhe VKB nr. 387, datë 05.12.2023, “Për përballimin pjesor të efektit financiar nga rritja e pagave me VKM 328, datë 26.10.2023, i ndryshuar”.

Sipas përcaktimit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47³, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44⁴, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c, “...Si rregull ndryshimet duhet të jenë minimale. Ndryshimet duhet të jenë të papranueshme në tremujorin e parë të vitit pasi kjo periudhë është shumë afër kohës së parashikimit fillestar”.

3. Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit

Treguesit e buxhetit për vitin 2023, është planifikuar në shumën 797,225 mijë lekë prej të cilit janë realizuar 751,336 mijë lekë ose i shprehur në përqindje plani është realizuar në masën 94%, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 30,176 mijë lekë ose në masën 4% të buxhetit faktik.

Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktuar nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore.

Në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44 dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, Bashkia Has ka përgatitur:

1. Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin vitit 2023 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 1117 prot., datë 29.05.2023;
2. Raportin e monitorimit të buxhetit për 8-mujorin e vitit 2023 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 806 prot., datë 20.09.2023;

³ Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brendamuajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse përndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin evitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

⁴ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

3. Raportin e monitorimit të buxhetit për 12-mujorin e vitit 2023 dhe e ka dërguar me shkresë në MFE nr. 665 prot., datë 15.02.2024.

Tabela nr. II.3.1: Realizimi i treguesve buxhetor dhe pasqyrimin në raportet e monitorimit për vitin ushtrimor dhe mënyra e përdorimit të të ardhurave

Nr	Emërtimi	Viti 2023							
		Plani fillim Viti Sipas VKB	Çelja Thesarit sipas akt rakordimit	Fakti sipas aktrakordimit	Të ardh veta	Grand	Trans. pakushtez Specifike	Tran. Kusht. Funk Deleg.	Tra. Kush Për Inv.
	Paga (600)	172,974	185,571	182,444	2,284	103,633	71,625	3,568	1,334
	Sigurime (601)	29,423	30,385	29,254		17,032	11,743	480	
	Shpenzime (602)	71,474	87,488	80,051	7,587	53,812	17,241	1,286	125
	Shpenzime (604)		3,394	3,393	384			3,009	.
	(604) F. Rezervë								
	Fondi Veçantë								
	Inv (230 +231)	24,713	130,606	102,540	13,569	2,633	7,337	74,020	4,980
	Transferta 606	6,032	359,781	353,654	1,372	2,854		349,428	
	Totali	304,616	797,225	751,336	25,196	179,964	107,946	431,791	6,439

Burimi: Bashkia Has

4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve

Në Bashkisë Has vlera e detyrimeve të prapambetura deri në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 586,787 lekë, si në raportimin në MFE ashtu dhe në rakordimet me Degën e Thesarit.

Tabela nr. II.4.1: Detyrimet e prapambetura në Bashkinë Has viti 2023

Nr.	Emërtimi i Objektivit të Prokurimit	Emërtimi i Subjektit Kreditor	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Vlera e kredisë (detyrim) në 31.12.2022	Shtesat gjatë vitit 2023	Shlyerjet gjatë vitit 2023	Vlera e detyrimit me 31.12.2023
1	Kolaudim punimesh Rruga Zahrisht	Xh & M. ShPK	-	Nr. 32, datë 21.11.2018	28,200	-	-	28,200
2	Rehabil i rrug Lagje Peka e Pazar i Vjetër	Z. ShPK	19.09.2018	Nr. 8, datë 03.06.2019	7,337,101	-	7,337,101	-
3	Ndërtim Ujësjesllesi Zahrisht (vazhd shtësa)	L.ShPK	-	Nr. 75, datë 24.09.2018	163,409	-	-	163,409
4	Ndërtim ujësjesllesi rajonal për NJA Golaj	L.ShPK	22.05.2020	Nr. 24/2022 datë 05.08.2022	1,475,314	-	1,475,314	-
5	Blerje, kancelari	M. & D.	-	Nr. 86090 dt 31.08.2022	516,000	-	516,000	-
6	Komision poste	Posta Shqiptare	01.06.2022	Nr. 117,119,129,131/2022	367,942	-	367,942	-
7	Blerje materiale pastrimi dhe të tjera mallra	H. 2012	07.06.2023	Nr. 70/2023 datë 08.06.2023	-	414,000	414,000	-
8	Ndërtim i rrugës nacionale Krumë-Kukës (Lagje Dida deri në Lagjen Geca dhe Rada)	V. Shpk	16.05.2023	Nr. 15/2023 datë 0708.2023	-	6,440,280	6,440,280	-
	Të tjera detyrime	Emërtimi i Subjektit Kreditor	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Vlera e kredisë (detyrim) 31.12.2022	Shtesat gjatë vitit 2023	Shlyerjet gjatë vitit 2023	Vlera e detyrimit me 31.12.2023
1	Pagesë V. Gjyqës për objekt Ish komun Golaj	A. I.	-	-	395,178	-	-	395,178
2	Shpërblime lindje	Fëmijë të lind deri 2018	-	-	1,050,000	-	1,050,000	-
	Totali i detyrimit				11,333,144	6,854,280	17,600,637	586,787

Burimi: Bashkia Has

Nga auditimi konstatohet se, sipas të dhënave të paraqitura në tabelën mësipërm, detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2022 janë në vlerën 11,333 mijë lekë, janë krijuara gjatë vitit 2023 detyrime në vlerën 6,854 mijë lekë dhe janë shlyer në vlerën 17,601 mijë lekë. Duke rezultuar të **ardhura të munguara për periudhën 31.12.2023 në vlerën 587 mijë lekë.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, "Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c)

tre vitet e ardhshme buxhetore...", neni 40, pika 3, "Projektbuxheti vjetor përfshin...informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore...detyrimet kontingjente dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës". Udhëzim i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 101, "Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim".

Mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore në Bashkinë Has

Nga auditimi rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore në vitin 2023 është në vlerën 395,178 lekë, për të cilën Bashkia Has ka Vendimin e Gjykatës nr. 940 dhe nr. 1011, datë 16.12.1994 dhe nuk ka dokumentacion tjetër përkatësisht një Urdhër nga zyra përmbarimore që të mund të shlyej detyrimin e krijuar për këtë çështje dhe si rezultat në fund të vitit 2021 rezulton e papaguar vlera 395,178 lekë.

Vështirësia Financiare e Bashkisë Has

Në UMFE nr.26, datë 27.03.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore", trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive. Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 Probleme Financiare, pika 1.

Për Bashkinë Has, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2023 ka vlerën 304,615,634 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2023, ka vlerën 586,587 lekë, sipas raportimit në MFE me shkresë nr. 665 prot., datë 15.02.2024. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 0.19%, shifër që e klasifikon Bashkinë Has në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare, paraqitur si në tabelën mëposhtë:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve Të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale Të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)			
a	Hua afatgjatë			
a,1	Marrëveshje financimi			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër			
b,1	Marrëveshje financimi			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	586,587		0.19%
Llog. ekonomik				
4864100	Vendime gjyqësore	395,178		
4864200	Detyrime të prapambetura për shërbime			
4864201	D.P. energji elektrike			
4864300	D.P. mirëmbajtje			
4864400	D.P. investime	191,409		
4864500	D.P. rimbursim TVSh			
4864600	Mallra			
4864900	D.P. të tjera			
4864601	D.P. sigurime shoqërore			

4864602	D.P. sigurime shëndetësore			
4864603	D.P. ardhura personale			
4864604	D.P. tatime			
4864901	Paga			
4864902	Shpronësime			
4864903	Transferta individuale			
4864904	Transferta subjektet			
III	Totali (I+II)	586,587	304,615,634	0.09%

5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSHH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre

Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **797,225** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **751,336** mijë lekë, ose në masën **94%**. Nga këto janë realizuar nga të ardhurat e veta 30,176 mijë lekë dhe vlera e mbuluar nga FZSHH është **721,160** mijë lekë, ose **96%**. Nga këto, fondi i pagave (Ilogaria 600) është realizuar me 99%, sigurime shoqërore dhe shëndetësore (Ilogaria 601) është realizuar me 100%, shpenzimet operative (Ilogaria 602) është realizuar me 91%, transfera korrente të brendshme (Ilogaria 604) është realizuar me 89%, transferime tek buxhetet familjare (Ilogaria 606) është realizuar me 100% dhe fondi i investimeve (Ilogaria 231) është realizuar me 82 %.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. M. D., Kryetar i Bashkisë Has;
2. Z. S. M., Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Taksave.

2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve.. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has bëhet mbështetur në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- VKB-në nr. 64, datë 22.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Has me shkresë nr. 3/58 prot., datë 09.01.2023.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Has për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifave vendore;
- Dokumentacioni i Drejtorisë së Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifave vendore;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;

- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar pagesat e kontratave të qirave të aseteve është:

- Kontratat e aseteve të dhëna me qira;
- Dosjet përkatëse të subjekteve që kanë marrë asete me qira;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion lidhur me monitorimet e kontratave dhe likuidimet e pagesave të qirave.

▪ *Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve*

Për vitin 2023 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has është miratuar me VKB-në nr. 64, datë 22.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Has me shkresë nr. 3/58 prot., datë 09.01.2023.

Tabela nr.II.6.1: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Has, viti 2023 000 lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	FAKT	%
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	35,311	30,704	87%
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	4,903	2,207	45%
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	400	107	27%
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	1,749	1,132	65%
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	1,675	995	59%
A.1.2.2	Taksa mbi token bujqësore	74	65	88%
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	-	72	
A.1.3	Taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndërtimet e reja	2,564	778	30%
A.1.4	Taksa e tabelës	190	190	100%
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	13,050	15,907	122%
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë/pasuritë e paluajtshme	-	-	-
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	8,500	9,520	112%
A.2.3	Taksa e rentës minerare	250	-	0%
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	4,300	6,387	149%
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	11,433	8,061	71%
A.3.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	6,165	4,531	73%
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	1,665	1,068	64%
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	600	600	100%
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	3,900	2,863	73%
A.3.2	Tarifa për ndriçimin publik	376	343	91%
A.3.2.1	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	60	60	100%
A.3.2.2	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	316	283	90%
A.3.3	Tarifa për gjelbërimin	198	196	99%
A.3.3.1	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	47	45	96%
A.3.3.2	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	151	151	100%
A.3.4	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	3,000	2,004	67%
A.3.4.1	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura	64	13	20%
A.3.4.2	Tarifa e licencimit të veprimtarive të transportit	228	180	79%
A.3.4.3	Tarifa për dhënie licencë për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	1,200	620	52%
A.3.4.4	Tarifa për pyjet dhe kullotat	882	696	79%
A.3.4.5	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrfikësja	20	5	25%
A.3.4.6	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe fasadave	606	490	81%
A.3.4.7	Tarifa nga dokumentet për tender, ankand etj.	-	-	
A.3.5	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj. (Konviktet)	300	50	17%
A.3.6	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	147	-	0%
A.3.7	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	662	437	66%
A.3.8	Tarifa të tjera	585	500	85%
A.4	Të Ardhurat e Tjera	5,925	4,529	76%
A.4.1	Qiraja nga asetet në pronësi të bashkisë	4,100	3,911	95%
A.4.2	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	300	332	111%
A.4.3	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	-
A.4.4	Grante nga ndihma ndërkombëtare	1,525	286	19%
A.4.5	Të tjera (Subvencione)	-	-	-
	TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË	35,311	30,704	87%

Burimi: Bashkia Has

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2023 janë realizuar në masën **87%** nga 35,311 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 30,704 mijë lekë.

Sipas përcaktimeve e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përkatësisht:

- Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Për vitin 2023 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has është miratuar me VKB-në nr. 64, datë 22.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Has me shkresë nr. 3/58 prot., datë 09.01.2023.

▪ Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c⁵ dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlera vetë zbatueshme për legalizim”, pika 5⁶.

Në Bashkinë Has struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipër cituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë është Sektori i Urbanistikës.

Në procesin e legalizimeve për vitin 2023 rezulton se, janë legalizuar 24 objekte me vlerë totale 1,068,602 lekë. (për më shumë informacion shiko aneksin II.6.1)

Nga auditimi konstatohet se lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se për vitin 2023 nuk ka paguar asnjë qytetarë me vlerë totale 1,068,602 lekë për 24 objekte të legalizuara. Gjithashtu për vitin 2022 nga muaji Korrik deri në fund të vitit janë legalizuar 15 objekte, me vlerë 660,821 lekë, dhe nga vitet e mëparshme deri në Qershor 2022 janë 266 debitorë në vlerë totale 10,313,690 lekë, **që përbën në total 12,043,113 lekë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has.**

▪ Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Has kryhet në programin Excel. Drejtoria e Financës dhe Taksave gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

Tabela nr.II.6.2: Numri i bizneset që ushtrojnë aktivitetet në Bashkinë Has 2023

Nr.	Lloji Biznesit	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	117	17	2	132

⁵Ligji nr. 95.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesat ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c “për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi”.

⁶VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5: “Taksavendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësitë të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

2	Biznesi Madh	46		3	43
	Gjithsej	163	17	5	175

Burimi: Bashkia Has

▪ Menaxhimi i borxhit

Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar **niveli i lartë e debitorëve**. Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistrimit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Has, rezultoi se ka nivel të lartë debitorësh në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, (për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie, tarifa e qirasë për objekte, toka, pyje, dru zjarri etj), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2022** vlera debitorëve është **42,557,390 lekë lekë** dhe në fund të **vitit 2023** vlera debitorëve është **44,002,268 lekë**. Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresivë paraqitet si mëposhtë.

Tabela nr.II.6.3: Debitorët progresiv, biznese dhe familjarë 2023, në lekë

Nr	LLOJI I DEBITOREVE	Periudha (13 VJECARE) 31.12.2011 deri me 31.12.2023		Shuma e Detyrimeve Progresiv 2022	Sisteme	Shtesa	Pakësime	Shuma e Detyrimeve Progresiv 2023
		Lloji i Detyrimeve						
1	Biznes i Vogël	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi, Taksë ndërtese, Taksë table	11,992,017		910,576	250,311	12,652,282
2	Biznes i Madh	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi, reklame, Tarife leje e licenca, Taksë ndërtese, Taksë Tabele, Qira fondi pyjor kullusor	14,833,722		1,330,844	964,090	15,200,476
3	Institucione Shtetërore	Taksa e Tarifa vendore		154,480		52,120	-	206,600
4	Kryefamiljarë të pajisur me leje legalizimi	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale të legalizuara	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	10,619,005			305,315	10,313,690
5	Qiramarrës të ambienteve të tregut (Markata)	Qira të ambienteve të tregut (Markata)	Qira ambienti hapësira publike	4,861,266		549,651	53,842	5,357,075
6	Qira Tokë Bujqësore	Tokë bujqësore		96,900	-	259,245	84,000	272,145
TOTALI				42,557,390	-	102,436	1,657,558	44,002,268

Burimi: Bashkia Has

Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Has paraqitet:

Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2023 është 3,102,436 lekë nga të cilat:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për biznesin e vogël në shumën 910,576 lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat për biznesin e madh në shumën 1,330,844 lekë
- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 52,120 lekë;
- Detyrime nga qiratë e tregut (markata) në shumën 549,651 lekë;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë në vlerën 259,245 lekë.

Gjendja e debitorëve progresiv të vitit 2022 rezulton në vlerën 42,557,390 lekë, gjatë vitit 2023 janë paguar detyrime në total në vlerën 1,657,558 lekë dhe nga shtesat në vlerën 3,102,436 lekë rezulton **gjendja e debitorëve progresiv është në vlerën 44,002,268 lekë:**

▪ Taksat dhe tarifat familjare

Në Bashkinë Has aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës. Nga të dhënat që disponon Bashkia Has rezulton se kanë paguar detyrimet për këto dy taksa/tarifa **1572 familje me vlerë 1,153,880 lekë**. Bashkia Has, Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitore ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifatat e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit. Bashkia Has nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësive administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitore nuk ka një regjistër.

Si rezultat, **procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitore dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë**. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e VKB nr. 78, datë 22.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has”, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

▪ Taksa mbi tokën bujqësore

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23⁷.

Sipas Aneksit 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Bashkia Has klasifikohet në kategorinë e katërt ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën mëposhtme:

Tabela nr.6: Vlera e taksës së tokës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	1,400
II	1,200
III	1,100
IV	1,000
V	900
VI	800
VII-X	700

Referuar VKB-në nr. 64, datë 22.12.2022, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2023”, toka bujqësore në Bashkinë Has klasifikohet në kategorinë VII-X me detyrim 700 lekë/ha/vit.

Nga auditimi konstatohet se, në Bashkinë Has familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe taksa e tokës bujqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021” pika 4/b. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet kur qytetarët paraqiten në bashki në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifatat

⁷Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 1.

vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Sektori i Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 700 lekë/ha/vit kur bashkia ka të dhëna.

▪ Masat e marra për uljen e borxhit

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara.⁸

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 1 dhe 2, Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 89, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, pika 89, i ndryshuar. Pas kalimit të afatit për pagimin në mënyrë vullnetare të këtyre detyrimeve, Drejtoria e Financës dhe Taksave me shkresën nr. 221 prot, datë 21.07.2023ka njoftuar90 subjekte (biznes i vogël), me shkresën nr. 179 prot., datë 21.07.2023, ka njoftuar 20 subjekte (biznes i madh - aktiv), me shkesën nr. 181 prot., datë 21.07.2023, ka njoftuar 18 subjekte (detyrime të mëparshme që nuk ushtrojnë aktualisht në Has), me shkresë 387 prot., datë 07.08.2023 janë njoftuar 264 subjekte përfitues të lejes së legalizimit për detyrimet e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Nga auditimit konstatohet se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës subjektet debitorë për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar, shkresa drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim e llogarive bankare të debitorëve ndaj bashkisë.

▪ Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

Në territorin e Bashkisë Has për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë për vitin 2023, 9 subjekte që e ushtrojnë këtë aktivitet. Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi⁹ dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore për vitet 2023.

Nga auditimi konstatohet se, nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 9 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, nga të cilat 1 pikë ka licenca me afat më të shkurtër se 5 vjet dhe me pagesa pjesore dhe 8 pika kanë licenca 5-vjeçare, të 9 subjektet kanë detyrime **me një efekt financiar me vlerë totale 4,447,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Has, sipas tabelës më poshtë.**

Tabela nr. II.6.4: Subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë debitorë

Nr	Operatori Ekonomik	NIPTI	Adresa	Autorizimi Bazë	Detyrime për t'u paguar	Pagesa viti 2021-2023	Debitor, lekë	Shënime
1	"S" shpk	K.....E	Krumë	10.09.2020-10.09.2025	1,000,000	800,000	200,000	

⁸Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 89, 90, 91, 93.

⁹Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2.

2	"D. H" shpk	J.....M	Krumë	18.11.2019-17.11.2022 18.11.2022-17.11.2024	1,000,000	800,000	200,000	
3	"V. P" shpk	K.....K	Krumë	01.11.2021-16.10.2026	1,000,000	600,000	400,000	
4	"E" shpk	J.....E	Krumë	19.11.2020-19.11.2025	1,000,000	100,000	900,000	Mbyllur 1.6.2021
5	"K. L" shpk	L.....U	Golaj	18.04.2018-17.04.2021 20.08.2021-17.04.2023	1,000,000	293,000	707,000	Mbyllur 1.1.2023
6	"Xh.P" shpk	L.....V	Vranisht	19.04.2019-18.04.2024	1,000,000	400,000	600,000	
7	"G. Sh." shpk	K.....H	Vranisht	16.03.2021-16.03.2026	1,000,000	400,000	600,000	
8	"H" shpk	J.....P	Golaj	14.01.2020-13.01.2025	1,000,000	200,000	800,000	Mbyllur 8.6.2022
9	"D. M" shpk	L.....M	Krumë	31.07.2023-30.07.2024	100,000	60,000	40,000	
					8,100,000	3,653,000	4,447,000	

Burimi: Bashkia Has, përpunoi grupi i auditimit

Ushtrimi i aktivitetit nga këto subjekte sipas dokumentacionit që bashkia disponon dhe janë të pajisur me autorizim, bie në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4 "Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme". Neni 20-Autorizimet pika 2. "Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11¹⁰, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. M. D., Kryetar i Bashkisë Has;
2. Z. S. M., Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Taksave
3. Z. U. H., Përgjegjës i Sektorit të Taksave

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

- 3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
- 3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë;
- 3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Për auditimin e pikës 3 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2023 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumenta kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2023, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2023.
6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Has në mbyllje të vitit buxhetor 2023.

¹⁰Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, neni 11 Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë".

8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel” si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret,shpenzimet te ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

▪ *Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:*

Për vitin 2023 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Has” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

▪ *Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare*

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Has për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr.475 prot, datë 27.02.2023. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Has dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

▪ *Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.*

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

▪ Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”
- Në përgjithësi janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore etj.

Konkluzion: Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **pika 2.2,** Kreu III, **pika 3.2** “Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme” **nënpikat 43. 44. 45.**

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon forHasi i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

▪ Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoriae Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2022 është në vlerën 2,180,466,935 lekë dhe për vitin 2023 është 2,207,069,435lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Formati nr.1 Aktivi i Bilancit 2023 Në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	A K T I V E T	2,207,069,435	2,180,466,936
2		I.Aktivet Afat shkurt	161,532,019	144,102,610
3		1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre	48,169,431	15,496,301
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	48,169,431	15,496,301
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	22,226,749	19,186,719
12	312	Materiale	118,411	180,478
13	327	Inventar I imet	22,108,338	19,006,241
14	33	Prodhim ne proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketushme	91,135,839	109,419,590
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	914,949	914,949
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	70,461,012	69,067,840
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	19,759,878	39,436,801
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	0	0
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		II.Aktivet Afat gjata	2,045,537,416	2,036,364,326
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	1,754,367	1,791,490
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	1,754,367	1,791,490
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme	0	0
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	1,859,671,223	1,917,861,010
48	210	Toka, T,roje, Terene	1,074,183	1,074,183
49	211	Pyje, Plantacione		0
50	212	Ndertesa e Konstruksione	662,045,813	696,890,331
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,125,026,150	1,152,291,128
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	33,306,233	33,174,975
53	215	Mjete Transporti	22,108,394	19,080,206
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	5,941,538	5,181,275
57	24	Aktive afatgjata te demtuara	10,168,912	10,168,912
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	184,111,826	116,711,826

63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	184,111,826	116,711,826

AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 15,496,301 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 48,169,431 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica ne fillim te vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “ Teprica e likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte”.

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 15,496,301 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 48,169,431 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në me formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022” të pasqyrave financiare.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 19,186,719 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 22,226,749 lekë, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej 3,040,030 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 180,478 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 në vlerën 118,411 lekë, me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 62,067 lekë, e cila përfaqëson pakësim të gjendjes së mallrave në magazinë gjatë vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 19,006,241 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 në vlerën 22,108,338 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 3,102,097 lekë, e cila përfaqëson rritje të inventarit të imët për vitin 2022 nga blerjet me pagesë.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 109,419,590 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2023 në vlerën 91,135,839 lekë, ku kemi pakësim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i uljes së debitorëve krahasuar me vitin paraardhës.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhenie, deficite, gjoba” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2022 dhe në fund të vitit 2023. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”,** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 69,067,839 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 70,461,012 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 1,393,173 lekë, e cila ka ardhur nga rritja e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore, debitorët nga mos pagesa e qirasë për tokën

bujqësore, qerasë së tregut për zënie hapësirë publike, taksa ndikimit ne infrastrukturë si dhe nga vlera e taksa tarifa nga biznesi i vogël dhe ai i madh të pa arkëtuara. Analiza e gjendjes së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Gjendja e llogarisë 468 “Debitore te ndryshëm” me date 31.12.2023

Nr	Pershkrimi	Dokument	Gjendje 31.12.2022	Shtesa 2023	Pagesa 2023	Gjendje 31.12.2023
1	Debitorë nga KLSH	Klsh	23,241,868	0		23,241,868
2	Debitorë nga APP	APP	3,268,581	0		3,268,581
3	Debitorë subjektet e medha		14,849,163	1,330,844.00	964,090	15,215,917
4	Debitorë subjekte e vogla		11,976,576	910,576.00	250,311	12,636,841
5	Debitorë institucione buxhetore taksa vendore		154,480	52,120.00		206,600
6	Debitore Markata Qytetit Krume		4,861,266	556,783.00	53,842	5,364,207
7	Debitore Qera Toke		96,900	259,245.00	84,000	272,145
8	Debitore Ndikimi ne Infrastrukture		10,619,005		364,152	10,254,853
	Totali		69,067,839	3,109,568	1,716,395	70,461,012

Konkluzion: Referuar analizës së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjeve të gjendjeve shtesa-pakësime nga viti 2022 në vitin 2023 konstatohet se, vlera e shtuar e debitorëve ne vitin 2023 për takson e infrastrukturës prej 1,729,423 lekë nuk është përfshirë në gjendjen e kësaj llogarie në mbyllje të vitit 2023. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, **pika 32** Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 3.3.

- **Gjendja i llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”** në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësajllogarie në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 19,759,878 lekë, e cila rakordon me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, e cila përbëhet nga shuma e : llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 1,695,576 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 13,150,788 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 558,749 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 3,829,522lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 525,244 lekë.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :

Gjendja e llogarisë **486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale.

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata Materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuar në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivet Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 231 “Investime”). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,919,652,500 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,861,425,590 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,752,003,771 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,791,083,429 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

- **Gjendja e klasës 20 “Aktive Afatgjata jo Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,791,490 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,754,367 lekë që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën prej **1,791,490** dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **1,754,367** lekë, diferenca është vlera e amortizimit. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **10,814,027** lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën **11,045,627** lekë. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar në tabelën e paraqitur në Aneks.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në fund të vitit 2023 në vlerën neto 1,791,490 lekë dhe vlerë historike **9,960,627 lekë** i përket 27 projekt-studimeve për investime të pa kryera dhe të kryera në vitet e mëparshme, vlerë e cila nuk është shpërndarë, sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik **“Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata”** (përbërja dhe trajtimi kontabël), **Kreu II.** “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Pika 16/b. D.**

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve Materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2022.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 1,859,671,223 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,781,122,802 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë bruto dhe neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën prej 1,074,183. Kjo gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene" me date 31.12.2022

Nr.	Emertimi i Aktivit	Gjendja date 31.12.2020	Shtesa viti 2022	Gjendja 31.12.2022
1	Shpronësim për interes Publik (Ndertim rruge e trotuare Qyteti Krume)	1,074,183	0	1,074,183
	TOTALI	1,074,183	0	1,074,183

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 696,890,331 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 662,045,813 lekë. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” paraqitet e njëjtë si në mbyllje të vitit 2022 ashtu dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 966,447,807 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në të njëjtën vlerën 966,447,807 lekë. Pra nuk kemi ndryshim. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet nga viti 2022 në vitin 2023 paraqiten në Aneks:

Referuar analizës së gjendjes së llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”, sipas inventarit kontabël përfshihen të gjithë aktivet “Ndërtesa e konstruksione” të Bashkisë Has dhe njësie Administrative në varësi (Golaj, Fajza dhe Gjinaj).

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,152,291,128 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,125,026,150 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,596,154,541 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,627,644,078 lekë. Gjatë vitit 2023 janë bërë shtesat me pagesë në vlerën 31,489,537 lekë, ku janë kryer investime në rrugë e ujsjellsa, si dhe pagesa nga detyrimet e prapambetura etj. Analiza e shtesave së kësaj llogarie paraqiten në Aneks.

Llogaria	Emertimi I aktivit	Shtesat ne vlere
213	2136100 Ndertim kolektori ujrave te zeza Lagje Qerimaj,Gajrep&Pla	2,361,960.00
213	2136100 Ndertim KUZ,Ish Gjeologjia-Golaj,Vazhdim KUZ Lagje Bera	1,140,000.00
213	2136100 Ndertim kolektori ujrave te zeza Lagje Qerimaj,Gajrep&Pla	3,566,964.00
213	2133100 Reabilitim Rruges nga rruga kryesore Lagje Dida deri ne Lagjen Gec	1,000,000.00
213	2133100 Reabilitim Rruges nga rruga kryesore Lagje Dida deri ne Lagjen Gec	1,336,400.00
213	2136100 Ndertim Ujsjellsi rajonal	15,479,556.00
213	2136100 Ndertim Ujsjellsi rajonal	1,475,314.00
213	2136100 Ndertim Ujsjellsi rajonal	15,325,987.00
213	2133100 Reabilitim Rruges nga rruga kryesore Lagje Dida deri ne Lagjen Gec	516,348.00

213	2133100	Reabilitim Rruges nga rruga kryesore Lagje Dida deri ne Lagjen Gec	3,147,252.00
213	2133100	Projekte te financuar nga Ministria e Mbrojtjes	3,948,516.00
213	2133100	Reabilitim Rruges nga rruga kryesore Lagje Dida deri ne Lagjen Gec	2,776,680.00
213	2136100	Ndertim Ujsjellsi rajonal	17,188,310.00
213	2133100	Projekte te financuar nga Ministria e Mbrojtjes	2,632,344.00
213	2136100	Supervizim Ndertim Ujsjellsi rajonal	400,000.00
213	2133100	Reabilitim Rruges nga rruga kryesore Lagje Dida deri ne Lagjen Gec	1,686,972.00
213	2136100	Ndertim Ujsjellsi rajonal	17,530,833.00
213	2133100	Reabilitim Rruges nga rruga kryesore Lagje Dida deri ne Lagjen Gec	7,337,101.00
213	2133100	Projekte te financuar nga Ministria e Mbrojtjes	39,000.00
			98,889,537

Referuar analizës së shtesës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se, është në shumën 98,889,537 lekë, në të cilën është përfshirë në mënyrë të gabuar vlera e investimit me objekt: “Ndërtim Ujësjiellësi i NJA Golaj” në vlerën 67,400,000 lekë, sepse ky aktiv nuk është kapitalizuar, pasi është në proces punimesh ndërtimi dhe financimi. Për këtë vlerë është kryer veprimi kontabël në debit të llog. 231 “Investime në proces” në kredi të llog. **213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”**, gjë e cila është reflektuar në gjendjet e llogarive përkatëse në bilanc.

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 33,174,975 dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën 33,306,233 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 73,366,691 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 75,859,409 lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar shtesa me pagesë në vlerën 2,492,718 lekë, të cilat përfaqësojnë blerjet e bëra për konteniere pastrimi etj. Ndryshimet e aktiveve në këtë llogari paraqiten në Aneks.

214	2140260	kontinier pastrimi 1.1 m3 metalik	cope	23.00	1159200
214	2140260	kontinier per mbledhjen e mbeturinave 1.1 m3	cope	22.00	1108800
214	2140260	gome mishi sis frenimi 1.1 m3	cope	40.00	8000
					2,316,000

Konkluzion: Referuar analizës së shtesave në gjendjen e kësaj llogarie rezulton se ka një diferencë prej 176,718 lekë e cila i përket vlerës së shpenzimit të kryer me Urdhër-shpenzimin nr.347 datë 14.06.2023 për shërbim dhe riparim kompjuterësh, vlerë e cila nuk duhet të kalonte në llogarinë e shpenzimeve 231 “Shpenzime për investime”, por në llog.602 “shpenzime operative”.

- **Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 19,080,206 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 22,108,394 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 31,190,166 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 35,172,364 lekë, vlera e amortizimit të akumuluar 12,109,960 leke. Gjatë vitit 2023 është shtuar vlera prej 3,982,198 lekë që i përket blerjes së mjetit traktor zvarritës buldozer. Për këto aktive është kryer inventari fizik, dhe inventari kontabël rakordon me vlerën në kontabilitet. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2022 deri në fund të vitit 2023 paraqiten në Aneks:

Inventari kontabel i llogarisë 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2022

Nr	Nr. llogarisë	EMERTIMI	Gjendja 31.12.2022	Shtesa gjatë vitit 2023	Gjendja 31.12.2023
1	2151110	motocikleta 125ccBrendKIEËAY model target125,nr LBBJ89007KBA38539,TARGA AZ118	323,252	0	323,252
2	2151110	motocikleta 125ccBrendKIEËAY model target125,nr LBBJ89007KBA41943,TARGA AZ311	323,252	0	323,252
		Shuma	646,504	0	646,504
3	2151120	Makine administrate ML	2,394,000	0	2,394,000
4	2151120	Makine tip JEEP	1,488,000	0	1,488,000
5	2151120	Makine ËOLSVAGEN	374,000	0	374,000

6	2151120	Veture Benz (HS 0801 A)	1,099,996	0	1,099,996
7	2151120	Eskavator me zinxhire, Volvo FC220D, seri-16121209, me kave germimi+patrimi 1800mm seri322196 (pompe graso, celes 17-13,24-27,30-32, kacavide)	16,347,130	0	16,347,130
		Shuma	21,703,126	0	21,703,126
8	2151140	Kamion	2,343,200	0	2,343,200
9	2151140	automjet (kamion)APV me vinc	4,999,200	0	4,999,200
		Shuma	7,342,400	0	7,342,400
10	2151160	automjet (mercedez)viti 1990, nafte,10964 CC, Nr. Shasie 61506425488919	545,173	0	545,173
11	2151160	mjeti tip mercedes benz, zjarrefikese me nr shasie 61506425495204	748,003	0	748,003
		Shuma	1,273,176	0	1,273,176
12	2151140	Pompa portative 20L per sherbimin zjarrefikes	204,960		204,960
		Shuma	204,960		204,960
13	2151140	Traktor Zvarrites (BULDOZIER)		3,982,198	3,982,198
		Shuma		3,982,198	3,982,198
		TOTALI 215	31,190,166	3,982,198	35,172,364

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 5,181,275 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,181,275 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 53,358,920 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 53,287,243 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 1,156,800 lekë te pajisjeve dhe transferime kapitale nga institucionet e tjera qendrore në vlerën 811,805.28 lekë. Ndërsa vlera e amortizimit e përlloritur është në shumën 49,314,310 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 24 “Aktive te qëndrueshme te trupëzuara të dëmtuara”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 me vlerën 19,669,113 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 19,669,113 lekë. Kjo shumë përfaqëson vlerën e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara, makineri e ndërtesa të paraqitur në tabelën në Aneks.

Nr	Nr. llogarise	EMERTIMI	Gjendja 31.12.202	Shtesa/pakësime per vitin 2022	Gjendja kontab. 31.12.2022
1	2420100	Shkolla 9-Vjecare Cahan	96,830		96,830
2	2420100	Ndertesa Muzeu Krume	97,420		97,420
3	2420100	Shkolla 9-Vjecare Kosturr	353,519		353,519
4	2420100	Depo Oksigjeni	6,205		6,205
5	2420100	Hangar 1 NB	48,890		48,890
6	2420100	Hangar 2 NB	124,450		124,450
7	2420100	Hangar 3 NB	50,000		50,000
8	2420100	Ish Zyrtar e sektorit te ujrave	21,615		21,615
9	2420100	Magazine e NB	86,022		86,022
10	2420100	Oficina 2kt	266,496		266,496
11	2420100	Oficina Krume	820,820		820,820
12	2420100	Rrethimi I ofcines NB	35,866		35,866
13	2420100	Shkolla Qafe Tobel	722,579		722,579
14	2420100	Shtepia e Kultures Fajza	304,379		304,379
15	2420100	Vend Roja NB	3,084		3,084
16	2420100	Shkolla Gjeologji	2,024,891		2,024,891
17	2420100	Shkolla Gjeologji e Vjeter	2,500,000		2,500,000
18	2420100	Shkolla Pla I pates	1,500,000		1,500,000
19	2420100	Shkolla Qarr	4,796,737		4,796,737
		Shuma	13,859,803		13,859,803
20	2420100	Stacion Pompimi Fajza	315,310		315,310
21	2440100	Stacion pompimi Tregtan Nr.3	120,000		120,000
22	2440100	Stacion Pompimi Kosturr	149,500		149,500
		Shuma	584,810		584,810
23	2450100	Makine Mitsubish	999,500		999,500
24	2450100	Kamion Tip Benz	4,225,000		4,225,000
		Shuma	5,224,500		5,224,500
		TOTALI	19,669,113		19,669,113

Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2023 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Ref llog.	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		paksime		Teprica në fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
c		1	2	3	4	5			8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	10,814,027	9,022,537	1,791,490	231,600	268,723	0	0	9,960,627	9,291,260	1,754,367
201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave	0		0	0		0	0	0	0	0
202	Studime dhe kerkime	9,729,027	7,937,537	1,791,490	231,600	268,723	0	0	9,960,627	8,206,260	1,754,367
203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	1,085,000	1,085,000		0		0	0		1,085,000	
21-28	II. AAGJ/ MATERIALE	2,741,189,744	823,328,734	1,917,861,010	39,933,058	98,122,845	0	0	2,781,122,802	921,451,579	1,859,671,223
210	Toka,troje,Terene	1,074,183	0	1,074,183	0	0	0	0	1,074,183	0	1,074,183
211	Pyje,Kullota Plantacione	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
212	Ndertime e Konstruksione	966,447,807	269,557,476	696,890,331	0	34,844,518	0	0	966,447,807	304,401,994	662,045,813
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,596,154,541	443,863,413	1,152,291,128	31,489,537	58,754,515	0	0	1,627,644,078	502,617,928	1,125,026,150
214	Instalime teknike,makineri,pajsje,vegla pune	73,366,691	40,191,716	33,174,975	2,492,718	2,361,460	0	0	75,859,409	42,553,176	33,306,233
215	Mjete transporti	31,190,166	12,109,960	19,080,206	3,982,198	954,010	0	0	35,172,364	13,063,970	22,108,394
216	Rezerva shtetore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
218	Inventar ekonomik	53,287,243	48,105,968	5,181,275	1,968,605	1,208,342	0	0	55,255,848	49,314,310	5,941,538
24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	19,669,113	9,500,201	10,168,912	0	0	0	0	19,669,113	9,500,201	10,168,912
28	Caktime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	TOTALI (I+II)	2,752,003,771	832,351,271	1,919,652,500	40,164,658	98,391,568	0	0	2,791,083,429	930,742,839	1,861,425,590

- **Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale** paraqitet në bilanc në vlerën 1,576,934,229 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”pika 36. Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje te periudhes ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Has

Konkluzion: Për vitin 2023 nuk është kryer inventari i aktiveve materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, të Bashkisë Has dhe 4 NJA-ve, duke mos ushtruar kontroll mbi aktivet dhe menaxhimin e tyre në lidhje me vërtetimin e saktësisë, cilësisë e gjendjes fizike të tyre në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efijencë të tyre dhe shmangien e humbjeve.

Mos realizimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të paktën një herë në vit është veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu IV. “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, **pikat 73** “Inventarizimi i aktiveve” përcaktohet se: “*Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efijencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhër/ udhëzim të miratuar nga titullari i njësisë publike.*” dhe **në pikën 74** përcaktohet se: “*Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës*”

Konkluzion Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) të klasës 21 për vitin 2023 është në vlerën 3,211,522,798 lekë, ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet e aktiveve gjatë vitit 2023 për shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 1,074,183 lekë; 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 966,447,807 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,627,644,078 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në

vlerën 75,859,409 lekë janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2023 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas amërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30, me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël).

-Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet me vlerën prej 116,711,826 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 111,090,632 lekë, për të cilën u paraqit analiza e detajuar.

NR.LLOG	OBJEKTET NË PROCES	GJENDJE 31.12.2022 (NE LEKE)	Shtesa gjate vitit 2023 (NE LEKE)	Gjendje në 31.12.2023 (NE LEKE)
2312113	Mbjellje peme oborri I shkolles golaj	326,708		326,708
2312113	Mbjellje peme oborri I shkolles nikoliq	89,234		89,234
2312118	Rikonstrukcion pallati 4kt, rruga Dardania	24,499,084		24,499,084
Shuma llog. 212		24,915,026		24,915,026
2313400	Ndertim Ujesjellesi Rajonal per njesine administrative Golaj, Për fshatrat Dobrone, Qarr I Vogel, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has	90,000,000	67,000,000	157,000,000
2313400	Supervizim Ndertim Ujesjellesi Rajonal per njesine administrative Golaj, Për fshatrat Dobrone, Qarr I Vogel, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has	1,796,800	400,000	2,196,800
Shuma llog.213		91,796,800		159,196,800
SHUMA TOTALE 212 + 213		116,711,826	67,400,000	184,111,826

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Në lekë

Nr. Reshti	Referenca Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur 2023	Ushtrimi Paraardhes 2022
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	104,472,822	117,871,048
66		I.Pasivet Afat shkurtra	104,472,822	117,871,048
67		1. Llogari te Pagushme	104,472,822	117,871,048
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	1,695,576	21,226,756
69	42	Detyrime ndaj personelit	13,150,788	13,167,588
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	558,749	815,168
73	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	3,829,522	3,715,507
76	436	Sigurime Shendetsore	525,244	511,783
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore për mjete ne ruajtje	13,336,983	8,451,458
82	467	Kreditore te ndryshem	0	
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime	71,375,960	69,982,788
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		0
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		

95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	2,102,596,613	2,062,595,888
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	2,102,596,613	2,062,595,888
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	2,067,764,165	2,055,551,045
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	34,832,448	7,044,843
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	2,207,069,435	2,180,466,936

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 117,871,048 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 104,472,822 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 21,226,756 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,695,576 lekë, vlerë e cila ka ardhur në ulje krahasuar me vitin 2022. Sipas PF në mbyllje të vitit ushtrimor 2022, gjendja e llog. 401-408 paraqitet në vlerën 9,893,612 lekë e ndarë nga gjendja e llog. 467 “kreditorë të ndryshëm”. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analiza e llogarisë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”

Nr.	Data	Llog	Vlera	Emertimi	Furnitori	Ekstrakte	Shenime
1	13.12.2023	602	9,600	Kolaudim punimesh	Projekt D. 2019 Shpk	fatura 21/2023	Prokurim mallra
2	26.12.2023	602	566,389	Energji Elektrike dhjetor 2023	FSHU	Pemb fatura	Sherbime standarte
3	28.12.2023	602	532,800	Dekori I qytetit	O. H.	Fat. 28.12.2023	Prokurim mallra
4	21.11.2018	602	28,200	Kualidim punime rruga Zahrisht	Xh & M. Shpk Det Prapamb	fature nr.32	Prokurim sherbime
5	24.09.2028	602	163,409	Ndertim ujesjellesi Zahrisht	L.shpk Detyrim I prapamb	Fature nr.75	Prokrim ndertime
6	pa date		395,178	Vendim gjyqsor	A. I. Detyrim I prapamb		VGJ ish komuna Golaj
	Totali		1,695,576				

Referuar analizës rezulton se në gjendjen e kësaj janë përfshirë vlera e 3 faturave të periudhave të hershme mbi 60 ditë, si ato të vitit 2018 në vlerën 586,787 lekë, të cilat i përkasin gjendjes së llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 13,150,788 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën kontabël 558,749 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 3,829,522 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2023 është në vlerën kontabël 525,244 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 69,982,788 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 71,375,961 lekë, vlera të cilat rakordojnë me shumën e gjendjeve të llogarive kundërpartit në aktiv të bilancit si llog 468

“Debitorë të ndryshëm” në vlerën me llog.423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 914,949 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 8,451,458 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 13,336,983 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Has në mënyrë analitike.

- **Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqitet si në mbyllje të vitit 2022 në vlerën dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë, ndërkohë në PF në mbyllje të vitit 2022 kjo llogari paraqitet me gjendje në vlerën 11,333,144 lekë, vlerë që në mënyrë të gabuara i ka kaluar llog.401-404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, pasi përfaqësojnë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve mbi 60 ditë dhe një pjesë viteve 2017-2018-2019,

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në **Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare të PF të vitit 2023** paraqitet më poshtë:

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën **680,590,837** lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Has paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 5,869,397 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 106,941lekë, e cila përfshin *Taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 1,031,205 lekë, e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin* dhe rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7029 “Te tjera tatime mbi pasurine”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 64,976lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin* dhe rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

d. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 4,666,275 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në PF e 2023 në vlerën 9,958,871 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në PF e 2023 në vlerën 4,060,534 lekë, e cila përfshin qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në PF e 2023 në vlerën 5,898,337 lekë, e cila përfshin tarifatat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën prej 18,586,594 lekë, vlerë kjo, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën 19,759,878 lekë

të aktivitetit të bilancit, pasi kjo gjendje duhet të pasqyrojë detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 3.3** “ Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nën-pika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin”

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 645,758,389 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 182,444,350 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin.
- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2023, paraqitet në PF në vlerën 26,057,330 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin .
- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në PF për vitin 2023 në vlerën 80,051,250 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin.
- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në PF për vitin 2023 në vlerën 3,394,486 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.
- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në PF për vitin 2023 në vlerën 353,654,097 lekë, e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.

Per vitin 2023 totali i të ardhurave është 680,590,837 lekë dhe totali i shpenzimeve është 645,758,389 lekë. Diferenca e tyre 34,832,448 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2023 është në vlerën 3,040,030 lekë .

Nga testi kontrollit për vitin 2022 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet e arkëtimit kryhen me arkë, për të gjitha rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore, pagesat e konviktit, ujit të pijshëm, tarifave të biznesit, pagesa për lëndë drusore, tarifat për sistemin e vdiqjes, tarifat familjare, taksë toke dhe ndërtesë...etj, dhe sipas rasteve brenda ditës apo në fund të çdo jave derdhjet e arkës bëhen në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit. Nga auditimi u konstatua se, dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut III pika 34 dhe 35 germa a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 "Për limitin e arkës".

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe

nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave Materiale, veprimet me magazinën.

-Mbjajta e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga nen/Kryetari dhe Kryetari.

- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për të gjithë ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, përlllogaritur amortizimi, duke patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Janë hapur kartelat e zyrave për inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. S. M. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe të hartuesit të pasqyrave financiare.

3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënien me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve kontraktore

Në realizimin e auditimit të kësaj pike të programit e u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Inventarët e aseteve të transferuara në pronësi/përdorim me VKM Bashkisë dhe NJA nga Pushteti Qendror.
2. Listat e aseteve të kaluara në pronësi të bashkisë së bashku me certifikatat hipotekore, si dhe lista e aseteve për të cilat janë përgatitur dokumentet tekniko-ligjore të depozituar në ASHK për paisjen e Bashkisë me certifikatë hipotekore pronësie për këto asete.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

➤ **Asetet e kaluara nga pushteti qendror pranë Bashkisë Has paraqiten, sipas VKM-ve**
Referuar të dhënave të Zyrës së Menaxhimit të Aseteve rezulton se, janë 650 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Has dhe 4 e Njësi Administrative, listat përfundimtare të të cilave janë të miratuara me VKM-së përkatëse. Në mënyrë të përmblodhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Njësia Vendore	VKM		Në Pronësi Në numër	Në përdorim Në numër	Gjithsej prona te transferuara	Faza e transferimit	Nga këto regjistruar
		Numër	Datë					
1	Ish Bashkia Krumë	540	27.07.2016	50	10	60	Perfundimtare	20
2	Ish Bashkia Krumë	946	02.09.2009	170	8	178	Perfundimtare	
3	Ish Komuna Golaj	105	03.02.2008	293	16	309	Paraprake	
4	Ish Komuna Fajze	425	08.04.2008	52	8	60	Paraprake	
5	Ish Komuna Gjinaj	792	16.11.2006	43		43	Fillestare	
	Shuma					650		

- Për **Bashkinë Has** (Bashkia Qendër) janë transferuar 238 prona, ku me VKM nr.946, datë 02.09.2009 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish Bashkisë Krumë , të Qarkut të Kukësit”(178 prona) dhe me VKM nr.540, datë 27.07.2016 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish-Bashkisë Krumë, të Qarkut të Kukësit” ”(60 prona).

- Për **Njësinë Administrative Golaj** janë transferuar 760 prona, nga të cilat 451 pyje e kullota dhe 309 prona të paluajtshme. Pronat në pyje dhe kullota janë transferuar në fazë përfundimtare me VKM nr.113, datë 03.02.2008 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave,Pyje dhe Kullota që do të transferohen në përdorim të njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, Komuna Golaj të Qarkut të Kukës. Ndërsa 309 pronat e paluajtshme janë transferuar në fazë paraprake me VKM Nr.105, datë 03.02.2008 “Për Miratimin e Listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish Komunës Golaj të qarkut të Kukësit.

- Për **Njësinë Administrative Fajza** janë transferuar 173 prona të paluajtshme, nga të cilat 113 pyje dhe kullota 60 prona të paluajtshme. Pronat në pyje dhe kullota janë transferuar në fazë përfundimtare me VKM nr.418, datë 08.04.2008 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave,Pyje dhe Kullota që do të transferohen në pronësi të njësisë së Vetëqeverisjes Vendore,Komuna Fajza të Qarkut të Kukësit. Ndërsa 173 pronat e paluajtshme janë transferuar në fazë paraprake me VKM Nr.425, datë 08.04.2008 “Për Miratimin e Listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish **Komunës Fajza** të qarkut të Kukësit.

- Për **Njësinë Administrative Gjinaj** janë transferuar 191 prona të paluajtshme, nga të cilat 148 pyje dhe kullota 43 prona të paluajtshme. Pronat në pyje dhe kullota janë transferuar në fazë përfundimtare me VKM nr.111, datë 03.02.2008 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave, Pyje dhe Kullota që do të transferohen në përdorim të njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, Komuna Golaj të Qarkut të Kukësit. Ndërsa 43 pronat e paluajtshme janë transferuar në fazë fillestare me VKM nr.792, datë 16.11.2016 “Për Miratimin e Listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komuna Golaj të Qarkut të Kukësit.

- **Pyjet dhe Kullotat**, janë transferuar në mënyrë të përmblodhur për gjithë territorin e Bashkisë Has në mënyrë përfundimtare gjithsej 1209 prona pyje-kullota me **VKM nr. 684 datë 02.09.2020** “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të

Ministrave, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave /Bashkive” të ndryshuar, ku sipërfaqja e transferuar është gjithsej **30017.18 ha**, nga këto:

- Pyje 23775.3 ha,
- Kullotë dhe Livadhe 5524.4 ha
- Toka jo produktive, inproduktive 93.35 ha
- Shkëmbore dhe ujore 527 ha
- Të Eroduara 527 ha etj.

Nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me rregjistrimin e prona pyje dhe kullota rezultojnë se: Në vitin 2021 Ministria e turizmit dhe Mjedisit ka kontaktuar Kompaninë Datech për rregjistrimin e pronave dhe pyje dhe kullota të Bashkisë Has pranë ASHK. Për këtë ka bërë shpallje publike të këtyre pronave në ambientet e Brendshme të Bashkisë Has, sipas afateve ligjore 40 ditore për ankesa, kërkesa e dokumente plotësues etj. Pas përfundimit të rregjistrimit të këtyre pronave pyje dhe kullota Kompania Datech I ka sjellë Bashkisë listen e inventarit të përditësuar të pronave pyje dhe kullota, ku një kopje të tij e ka Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP) Tiranë, sipas transferimit përmbledhës gjithsej 1209 prona pyje dhe kullota të transferuara përfundimisht me VKM nr.684, datë 02.09.2020. Megjithatë procesi i rregjistrimit në ASHK i pronave pyje-kullota nuk është realizuar, pasi mungon përgjigja e këtyre institucioneve për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave, si dhe nuk është përgatitur dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor i tyre dhe për pasojë nuk është aplikuar dhe nuk është kryer finalizimi i hipotekimit të këtyre pronave.

Në bazë të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, kreu III, neni 11, pika 2/b Drejtoria e Pyjeve ka të miratuar plan afatgjatë është hartuar plan menaxhimi e mbarështimi për pyjet dhe kullotat me vlefshmëri përdorimi për një periudhë 10 vjecare 2021-2031 në 5 ekonomi pyjore me shtrirje të gjërë. Ky plan afatgjatë mbarështimi I pyjeve dhe kullotave është miratuar me VKB nr.27 datë 30.03.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr.311, datë 12.04.2022 dhe i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.329, datë 26.10.202.

➤ Asetet e rregjistruara si pronë e Bashkisë pranë ASHK-Drejtoria Vendore Has

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultojnë se nga Bashkia Has është përgatitur dokumentacioni tekniko-ligjor për 26 prona të paluajtshme nga pronat e transferuara me VKM, të cilat janë dërguar me shkresë pranë ASHK, Drejtoria Has dhe janë në proces aplikimi në sistem E-Albania, për realizimin e rregjistrimit. Këto prona paraqiten në tabelën e mëposhtme:

NR.	Emërtimi I pronës	NR.	Emërtimi I pronës
1	4/192 Truall, Bashkia Has Lulishte	24	5/7 Shesh, Bashkia Has Lulishte
2	4/29 Truall, Bashkia Has Lulishte	25	5/273 Shesh, Bashkia Has Lulishte
3	4/191 Shesh, Bashkia Has Shesh + Lulishte	26	5/30 Shesh, Bashkia Has Lulishte
4	4/112 Shesh, Bashkia Has Lulishte	27	5/29 Shesh, Bashkia Has Lulishte
5	4/179 Shesh, Bashkia Has Rruge + Lulishte	28	5/32 Shesh, Bashkia Has Lulishte
6	4/205 Shesh, Bashkia Has Rruge + Lulishte	29	5/28 Shesh, Bashkia Has Lulishte
7	4/223 Shesh, Bashkia Has Lulishte	30	5/209 Shesh, Bashkia Has Lulishte
8	4/171 Shesh, Bashkia Has Lulishte	31	5/340 Shesh, Bashkia Has Shesh + Lulishte
9	4/225 Shesh, Bashkia Has Lulishte	32	5/34 Shesh, Bashkia Has Shesh
10	4/78 Shesh, Bashkia Has Lulishte	33	5/258 Shesh, Bashkia Has Lulishte
11	4/79 Shesh, Bashkia Has Lulishte	34	5/5 Truall, Bashkia Has Shesh
12	4/100 Shesh, Bashkia Has Lulishte	35	5/25 Shesh, Bashkia Has Shesh + Rrugë
13	4/102 Shesh, Bashkia Has Lulishte	36	5/26 Shesh, Bashkia Has Lulishte
14	4/103 Shesh, Bashkia Has Lulishte	37	5/170 Shesh, Bashkia Has Lulishte
15	4/109 Shesh, Bashkia Has Lulishte	38	5/171 Shesh, Bashkia Has Lulishte
16	5/47 Shesh, Bashkia Has Lulishte	39	5/172 Shesh, Bashkia Has Lulishte

17	5/49	Shesh, Bashkia Has	Lulishte	40	5/169	Rruge, Bashkia Has	Rruge
18	5/52	Shesh, Bashkia Has	Lulishte	41	5/83	Shesh, Bashkia Has	Shesh
19	5/77	Shesh, Bashkia Has	Lulishte	42	5/248	Truall, Bashkia Has	Shesh
20	5/55	Shesh, Bashkia Has	Lulishte	43	5/349	Shesh, Bashkia Has	Lulishte
21	5/11	Truall, Bashkia Has	Lulishte	44	5/60	Shesh, Bashkia Has	Shesh
22	5/214	Truall, Bashkia Has	Rrugë + Lulishte	45	5/351	Truall, Bashkia Has	Shesh
23	5/19	Shesh, Bashkia Has	Lulishte	46	5/43	Truall, Bashkia Has	Shesh

Nga pronat e transferuara dhe të aplikuara për certifikatë pronësie, për 20 prona ka dalë certifikata e pronësisë nga ASHK, Drejtoria Has, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. pas	Nr. dok. Hipotekor (Kodi Unik)	Data e regjistrimit	ZK	Adresa	Sip truall m ²	Sip ndertimi m ²
1	SHESH	4/212	2282003004	21/02/2022	2282	Has Rr. Demokracia	62m ²	0
2	SHESH	4/38	2282003180	21/02/2022	2282	Has Rr. Demokracia	754m ²	0
34	SHESH	4/210	2282003223	21/02/2022	2282	Has Rr. Plepave	506m ²	0
5	SHESH	4/213	2282004071	21/02/2022	2282	Has Rr. Kastiotet	355m ²	0
6	SHESH	4/35	2282003177	21/02/2022	2282	Has Rr. Demokracia	704m ²	0
7	SHESH	4/191	2282007032	21/02/2022	2282	Has Rr. Kosoves	592m ²	0
8	SHESH	5/22	2282004050	30/06/2021	2282	Has Rr. Kuksit	1379m ²	0
9	SHESH	5/273	2282004109	07/02/2022	2282	Has Rr. Blinave	296m ²	0
10	SHESH	5/345	2282004014	07/02/2022	2282	Has Rr. Blinave	81m ²	0
11	SHESH	5/67	2282004061	07/02/2022	2282	Has Rr. Blinave	255	0
12	SHESH	5/66	2282004060	07/02/2022	2282	Has Rr. Blinave	169m ²	
13	SHESH	5/299	2282007063	07/02/2022	2282	Has Rr. Blinave	271m ²	0
14	SHESH	5/65	2282004089	07/02/2022	2282	Has Rr. Blinave	259m ²	0
15	Terren Sportiv	4/57	1210993	01.06.2019	2282	HAS QYTETI Krumë	3557M ²	0
16	Ndërtesë (Thertore)	1/81 - ND	266090	06.12.2018	2282	Krumë Rr. Kuksit	100m ²	100m ²
17	SHESH	4/249	1210107	07.09.2019	2282	Krumë	298m ²	0
18	SHESH	4/114	1210992	01.06.2019	2282	Krumë	760m ²	0
19	TRUALL	4/167	266610	02.03.2017	2282	Krumë	472m ²	0
20	SHESH	4/209	266615	11.04.2017	2282	Krumë Rr. Kastriotet	1148	0

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit të listave të inventarëve të aseteve rezulton se, janë 238 prona të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Has (Qendër), listat përfundimtare të të cilave janë të miratuara me VKM-ët përkatëse, ndërsa për 412 prona të 3 Njësive Administrative si **Golaj e Fajza** janë në fazën e miratimit të listave paraprake dhe **Gjinaj** në fazën fillestare. Nga këto prona janë hipotekuar 20 pasuri të paluajtshme dhe janë në proces aplikimi për certifikim hipotekor 26 pasuri të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë inventarizimi dhe përditësimi i të dhënave të këtyre pronave, pasi duhet që përmjet verifikimit në terren, dokumentacionit dhe korrespondencës zyrtare me institucionet përkatëse për statusin e tyre duhen identifikuar e propozuar e marrjen masave për ndjekjen e procedurave ligjore për të vepruar me ato prona që janë inekzistente fizikisht, të zaptuara, të kthyera pronarëve apo të privatizuara, të cilat duhen identifikuar në listat e pronave. Bashkia Has nuk ka strukturë të ngritur për menaxhimin e aseteve, përveç një specialisti me emërtim “Inspektor i pronave” pjesë e Sektorit të Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës dhe në Rregulloren e Brendshme të miratuar me shkresën nr.prot.05, datë 30.01.2019 të Titullarit të institucionit, ky pozicion nuk ekziston dhe si pasojë nuk ka të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Mungesa e kësaj strukture ka sjellë mungesë të kapaciteteve të plota për të kryer proceset e kalimit në pronësi përfundimtare të pasurive të Bashkisë Has. Për këtë detyrim ligjor Titullari i Bashkisë nuk ka nxjerrë asnjë urdhër për ngritjen e grupeve të punës për verifikimin e gjendjes faktike të pronës në terren dhe matjen faktike të pasurisë, për kryerjen dhe verifikimin e gjendjes juridike të pronës nëpërmjet ASHK për informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, përpunim i të dhënave të hedhura në sistemin përkatës të secilës pasuri sipas ZK,

plotësimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për çdo pronë dhe dërgimi i dosjes përkatëse me listën e pronave shtetërore të përditësuar pranë DV-ASHK Has.

Në mungesë të inventarizimit, përditësimit dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

Mos kryerja e procedurave për mos inventarizimi dhe përditësimi i listave paraprake dhe fillestare të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM për 3 NJA **Golaj, Fajza dhe Gjinaj**, më pas paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave të pronave, mos regjistrimi në ASHK në favor të Bashkisë i pjesës më të madhe të këtyre pronave të listuara, si dhe vlerësimi i tyre janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18,22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 ”Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”.

➤ *Të ardhura të munguara nga mos pagesa e qirave të kontratave të aseteve.*

Bashkia Has në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 28 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 1-30 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e parcelave nga fondi i tokave të pandara, parcelave nga fondi pyjor dhe kullor, për aktivitet bujqësor, për pemëtari, Antena, rruge nga miniera, ngritje fabrike përpunimi, studim-kërkim-zbulim minerali, Hec, agroturizëm etj. Kontrata e qiradhënies të lidhura nga Bashki Has me treguesit e tyre paraqiten në Aneks.

Konkluzion: Nga verifikimi i dokumentacioni e dosjeve të kontratave dhe pagesave të kryera rezulton se, në fund të vitit 2023 paraqiten 10 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 1,207,337 lekë**, veprime këto në kundërshtim me kontratat e lidhura të qiradhënies neni 4 “vlera e qirasë vjetore” dhe neni 5 “pagesa dhe rregjimi i saj”. Referuar tabelës mësipërme konstatohen 3 subjekte (Fabrika e Pasurimit Kromit Perollaj, Neza 2004, Vëllazëria Minerals Alb, Afrimi K), të cilat shfrytëzojnë asete të Bashkisë Has dhe nuk kanë një kontratë të nënshkruar me Bashkinë. Debitorët në mënyrë të përmbledhur paraqiten në Aneks.

Nr.	Subjekti	Kontrata nr. datë	Sip ha	Afati në vite	Debitore 31.12.2023
1	S.Xh.(toka)	16.03.2021	2.15	30	25,800
2	G. I.(toka)	21.03.2023	32528 m2	5	19,517
3	G. I.(toka)	22.03.2023	8.7582 ha	1	52,549
4	G. I.(toka)	12.06.2013	4	10	84,000
5	F. Shpk “P”(pyjor)	12.01.2015	0.63	9	91,350
6	V. A	19.06.2019	0.03	9	739,000
7	V. M. A.	Pa kontrat	0.672		104,832
8	A. M.	15.06.2023	8.96 ha	10	53,739
9	E. I.	21.03.2023	9.69 ha	1	58,140

10	E. I.	21.03.2023	10.4 ha	1	62,400
	Totali				1,207,337

Për kontratat shumë vjeçare u konstatua se, nuk janë të noterizuara si dhe nuk ka të dhëna, nëse janë regjistruar në ish-ZRPP Has aktualisht ASHK Drejtoria Has. Në asnjë rast të kontratave të qiradhënies të hershme nuk është parashikuar në kontratë marrja në konsideratë e ndryshimeve ligjore gjatë kohës, që shtrihet afati i kontratës sidomos në lidhje me tarifën e qirasë, si dhe nuk është kryer monitorimi i kontratave në lidhje me objektin dhe detyrimet e përdoruesit në kundërshtim me nenin “Të drejtat dhe detyrimet e Pronarit”. Gjithashtu marrja në dorëzim e objekteve, truallëve dhe parcelave si nga fondi pyjor dhe nga fondi i tokave bujqësore të pa ndara nuk është shoqëruar me inventarizimin fizik të gjendjes në terren e shoqëruar me procesverbalin e marrjes në dorëzim.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar nenet 826-840, me kontratat e lidhura kreu “dispozita të veçanta” **pika 4**, nenet “Pagesa”ose “Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesit”, me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 11/4 dhe neni 12/f dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kap III, pika 30.

Konkluzion: Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezulton se në territorin e Bashkisë Has ushtrojnë aktivitetin 17 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullësor, asete të Bashkisë Has. Nga Bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor, duke sjellë të ardhura të mungura për Bashkinë Has. Rastet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet nxjerrje prodhim minerale dhe inertesh në mënyrë të detajuar paraqiten në Aneks.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 391, datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, me VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore” i ndryshuar me VKM nr.267, datë 27.04.2023.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: z. L. M. në funksionin e ish-Kryetarit të Bashkisë Has (për periudhën janar-maj 2023), z.M. D. në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Has (për periudhën qershor-dhjetor 2023), z. Y. D. me detyrë inspektor i pronave, z. U. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.

hII. 4 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditore për zbatimin e rekomandimeve.

4.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

4.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH paraqitet:

Konkluzion: Nga ana e KLSH-së, janë lënë 27 masa organizative, 1 masë për shpërblimin e dëmit dhe 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet,eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 27 masa organizative të cilat janë pranuar nga Bashkia Has ku nga këto 7 janë të zbatuara, 12 janë të pazbatuara dhe 4 janë në proces zbatimi dhe 4 janë zbatuar pjesërisht.

b-Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë për shpërblimin e dëmit me 2 rekomandime të cilët janë pazbatuar.

c-Për përmirësimin e gjendjes është lënë 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet,eficence dhe efektivitet të fondeve publike me 3 rekomandime, ku këto rekomandime janë në proces zbatimi.

4.Masa disiplinore nuk janë dhënë

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. M. D. Kryetar i Bashkisë Has.

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Në zbatim të nenit 15, gërma “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Has ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 1082/1 prot., datë 30.05.2023, duke respektuar kështu afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Has nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, ku përcaktohet që: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

III. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak Has, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Bashkia Has ka hartuar planin e veprimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH shkresën me nr.prot.1082/1 e datës 30.05.2023 dërguar KLSH-së, por nuk ka raportuar rregullisht pranë Këshillit Bashkiak, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, ku përcaktohet që: “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë”.

IV. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Has administruar në KLSH me nr. 24/6 datë 06.04.2023, janë rekomanduar gjithsej:

➤ 23 masa organizative,

- 4 masa për uljen e borxhit
- 1 masë për shpërblim dëmi në shumën **265,845.521** lekë.
- 3 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet,eficence dhe efektivitet të fondeve publike.
- masa disiplinore nuk janë dhënë.

V. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Has, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	27	27	0
1-Masa për shpërblim dëmi	2 265,845.521 lekë	2 265,845.521 lekë	0
1-Masa për eliminimin e efekteve negative	3	3	0
Masa disiplinore	0	0	0
Totali	32	32	0

VI. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Has:

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	23	23	7	2	3	11
Masa për 3 E	3	3			3	
Masa Disiplinore	1	1				1
Masa për Uljen e Borxhit	4	4		2	1	1
Masa për Shpërblim Dëmi.	1	1				1
	32	32	7	4	7	14

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Has nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.Nuk është miratuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike, si prokurimet publike, shpenzimet, të ardhurat etj. Nga titullari nuk është nxjerrë akt i brendshëm ku të përcaktohen detyrat e punonjësit dhe strukturave përkatëse të Bashkisë Has gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës.Nga ana e titullarit të njësisë publike Bashkia Has nuk është hartuar dhe miratuar Strategji e Menaxhimit të Riskut, por është plotësuar vetëm Formati i Regjistrimit të Riskut.Ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave. Këto veprime janë në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 8, pika 2, 8\|b, neni 9 pika ç dhe neni 16 pika 2 dhe 3;
- VKM nr. 124,datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”Kreu III, pika 27;
- VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, Kreu VII, pika 49, 52, 52;
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”;

- Ligjit nr. 68-2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8 datë 29.3.2012 "Procedura e përgatitjes së Buxhetit afatmesëm", Kap. V. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa që hartohet dhe miratohet strategjia e rrishtit. Titullari i Bashkisë Has të miratojë gjurmën e auditimit për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme.

Koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën dhe formën e duhur të informacioneve cilësore me qëllim vlerësimin e progresit të bërë në arritjen e objektivave të MFK-së.

Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has të marrë masa që për çdo largim punonjësish nga puna të ndiqet procedura për dorëzimin e detyrës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit. Nga Bashkia Has nuk është marrë asnjë masë për hartimin e miratimin e strategjisë së rrishtit gjithashtu dhe grupi i menaxhimit strategjik nuk ka organizuar asnjë takim periodik sipas rekomandimit të lënë nga KLSH-ja.

Statusi i rekomandimit: **Pa zbatuar.**

2. Gjetje nga auditimi: Struktura e auditit të brendshëm për vitin 2022 ka funksionuar vetëm më një auditues, nga tre që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Rezultoni se për vitin 2022 nga Bashkia Has nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë auditim, duke mos kryer detyrën funksionale dhe duke mos i dhënë titullarit të njësisë publike këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe siguri për realizimin e objektivave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 10, Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, pika 1, Të gjitha njësitë publike, të përfshira në neni 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm dhe neni 11, Vendimin Nr. 83, datë 3.2.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik", pika 3. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa për ngritjen e strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si dhe një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë ose, shërbimi i auditit të brendshëm të kryhet nga njësi e auditit të brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësisë publike përkatëse.

Në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Nga Bashkia Has është nxjerrë urdhëri me nr.prot. 581 datë 22.06.2023, urdhër ky që ka bërë ndryshime në strukturën e Bashkisë duke vendosur sektorin e auditit të brendshëm me një përgjegjës dhe 2 specialistë por aktualisht përbehet vetëm nga një specialist.

Statusi i rekomandimit: **Pjesërisht**

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vite, ndërsa gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Në fillim të vitit buxhetor 2022 detyrimet e prapambetura kanë vlerën **19,089,192.8** lekë, është krijuar detyrim i ri gjatë vitit 2022 në vlerën 5,338,526 lekë, prej të cilave është likuiduar vlera

13,920,155 lekë, duke e çuar vlerën e këtyre detyrimeve më 31.12.2022 në vlerën **11,333,143.8** lekë. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Has dhe Drejtorja e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Has dhe kontraktorëve, brenda afatit 30 ditor pas ardhjes së faturës tatimore, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër nga subjekti nuk është marrë asnjë masë për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Has dhe kontraktorëve, brenda afatit 30 ditor pas ardhjes së faturës tatimore

Statusi i rekomandimit: **Pazbatuar**

4. Gjetje nga auditimi: Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Vlera totale e borxhit tatimor në Bashkinë Has paraqitet:

Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është 4,645,585 lekë nga të cilat:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifatat për biznesin në shumën 2,589,724 lekë;
- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 52,120 lekë;
- Detyrime nga qiratë e tregut (markata) në shumën 653,133 lekë;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,337,708 lekë;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore në vlerën 12,900 lekë

Në uljen e debitorëve kanë ndikuar pagesat e kryera për detyrimet debitorë të viteve para vitit 2021 në vlerën 2,514,241 lekë, dhe për vitin 2022 në vlerën 2,131,344 lekë.

Gjendja e debitorëve progresiv në fund të vitit 2022 është në vlerën 42,557,390 lekë.

Mosarkëtimi i takasve dhe të ardhurave nga kjo njësi vendore është në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive **42,557,390 lekë** e përbërë nga:

- 26,825,739 lekë për 187 subjekte private (biznesi i madh dhe i vogël);
- 4,861,266 lekë për qiratë e ambienteve të tregut (Markata e Qytetit Krume);
- 10,619,005 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet;

- 96,900 lekë nga kontratat e dhënies me qira të aseteve;

- 154,480 lekë nga institucione publike;

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Has, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Has janë marrë masa për zbatimin e detyrave ku janë njoftuar 90 subjekte debitorë të biznesit të vogël mbi detyrimet sipas shkresës me nr. 221 prot, datë 21.07.2023.

Janë njoftuar mbi 20 subjekte debitorë të biznesit të madh mbi detyrimet dërguar me shkresën nr. 197 prot, datë 21.07.2023.

Janë njoftuar 18 subjekte debitorë të biznesit të madh të cilët janë larguar nga territori i Bashkisë Has mbi detyrimet me shkresën me nr.181prot, datë 21.07.2023.

Është njoftuar subjekti "F." me shkresën me nr.249 prot, datë 25.07.2023, për shumën 3,171,900 lekë detyrime kontratë qeraje.

Janë njoftuar 264 subjekte debitorë përfituese të lejeve legalizimeve të cilat janë debitorë ndaj Bashkisë Has që nga viti 2017 e deri në muajin qershor 2022 sipas shkresës me nr.387 prot, datë 07.08.2023 për taksën e ndikimit në infrastrukturë me QKB-në, për moslejimin mbyllje biznesi pa arkëtuar detyrimet.

Statusi i rekomandimit: **Pjesërisht.**

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifën e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si, taksa e truallit. Si rezultat, procesi i llogaritjes së detyrimit të familjeve për taksat dhe tarifën vendore nuk është i dokumentuar, duke sjellë si pasojë mos njohjen e numrit të familjeve debitorë dhe vlerën totale që ato kanë ndaj Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr. 78, datë 22.12.2021, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has", me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandim: Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për krijimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

Komenti i grupit të auditimit

Bashkia Has, nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është marrë asnjë masë për krijimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë familjare.

Statusi i rekomandimit: **Pazbatuar**

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se *taksa mbi tokën bujqësore* është realizuar 35 mijë lekë nga 67 mijë lekë e planifikuar ose në masën 52%. Nga auditimi konstatohet se në Bashkinë Has nuk është hartuar regjistër dhe nuk llogaritet detyrim për kategorinë e taksapaguesve familjar për taksën mbi tokën bujqësore. Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet taksë e tokës bujqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021” pika 4/b (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandim: Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë nuk ka marrë asnjë masë për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta.

Statusi i rekomandimit: **Pazbatuar**

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet *rezulton se*, në Bashkinë Has ka detyrime të pa paguara në vlerën 9,282,639 lekë për 239 objekte objekte që janë legalizuar që nga viti 2017 deri në 31.12.2020 Nga korespondenca zyrtare e Bashkisë Has me ASHK **në vitin 2022** rezulton se:

- **Për vitin 2021** janë kryer 25 legalizime me vlerën e taksës së infrastrukturës të përlllogaritur prej 1,338,065 lekë, ku janë debitorë 19 individë në vlerën 1,090,592 lekë.

- **Për vitin 2022** janë kryer 12 legalizime me vlerën e taksës së infrastrukturës të përlllogaritur prej 545,206 lekë, ku janë debitorë 8 individë në vlerën 247,216 lekë.

Pra gjatë vitit 2022 listës së debitoreve i janë shtuar 37 individë për taksën e infrastrukturës është 1,337,708 lekë, ndërsa në vlerë progresive deri në 31.12.2022 është 10,620,347 lekë për 276 objekte, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has. Kjo procedurë është në kundërshtim me ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtime pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 dhe me VKB nr. 78 datë 22.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave

vendore në Bashkinë Has për vitin 2022” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 Rekomandim: Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Has të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 276 debitorë në vlerën 10,620,347 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Has të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Nga Bashkia Has nuk është marë asnjë masë nga Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Has që të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 276 debitorë në vlerën 10,620,347 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen.

Statusi i rekomandimit: **Pazbatuar**

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has në kuadër të administrimit të aseteve për krijimin e të ardhurave ka lidhur 26 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi apo në përdorim. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik për afate kohore nga 1-30 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, për aktivitet bujqësor, për pemtari, objekte banimi, Antena, venddepozitim minerali dhe ngritje fabrike perpunimi, studim-kerkim-zbulim, agroturizëm etj. Referuar tabelës së kontratave të qirave me të dhënat të nxjerrë dokumentacioni i dosjeve nga rezultoni në fund të vitit 2022 paraqiten 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në *vlerën 2,965,416 lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has*. Gjithashtu për qiramarrësit, që nuk kanë paguar detyrimet e qirasë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave nuk është llogaritur kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.

Theksojmë se në rastin e qiramarrësit “F” shpk kontrata bazë 9 vjecare e datës 12.01.2015 me tarifë qiraje 465,000 lekë është amenduar me kontratën e datës 01.06.2016, ku sipërfaqja e marrë me qira dhe afati nuk ndryshon, por ka ndryshuar vlera e kontratës në 91,350 lekë i pa shpërndarë me relacion për shpjegimin arsyeve të ndryshimit të vlerës së qirasë vjetore. Kjo ka sjellë diferencën në pagesë nga qiramarrësi prej 2,241,900 lekë (2,790,000 - 465,000), e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has, e cila është pjesë e shumës debitorë të mësipërme.

Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezultoni se në territorin e Bashkisë Has ushtrojnë aktivitetin 21 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullor, asete të Bashkisë Has. Nga bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për vend depozitimin mineralit në rastet e subjekteve me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali si dhe shfrytëzim karriere dhe shtrati lumi, me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim inertesh, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Has. Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015,

“Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën 2,965,416 lekë dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave. Gjithashtu nga strukturat drejtuese për 21 rastet e subjekteve subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare e inertesh, që ushtrojnë aktivitetin e licencuar në parcelat e fondit pyjor-kullësor, asete të Bashkisë Has, të shqyrtohet dokumentacioni i tyre dhe të kryhen kontrolli dhe matja në terren i parcelave që shfrytëzohen dhe finalizimi i procesit me lidhjen e kontratave të qiradhënies për sigurimin e të ardhurave dhe rehabilitimin e sipërfaqeve nga shfrytëzimi nga ana e këtyre subjekteve të aseteve të bashkisë. Nëse ka pengesë në realizimin e këtij procesi të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse deri në pezullimin e veprimtarisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Nga 2,965,416 lekë të ardhura të munguara në vitin 2022 kanë mbetur detyrime kontraktore të pa arkëtuara në vlerën 639,516 lekë, sipas argumentimit të mëposhtëm:

1. S. Xh. nuk ka paguar tarifën e vitit 2022 prej 12,900 lekë.
2. G. I ka paguar detyrimet 84,000 lekë për vitin 2022.
3. “F” është njoftuar me shkresën me nr. 249 prot, datë 25.07.2023 për shumën 2,241,900 lekë, diferencë tarife e konstatuar nga KLSH, për të cilën nuk është kryer amendim i detyrimit të kontratës për ndryshim tarife, me qëllim që të njihet ligjërisht si detyrim.
4. V. A. ka paguar me datë 04.01.2024. Kjo për shkak të problemeve teknike pasi Bashkia Has nuk arrinte të priste faturen e fiskalizuar.
5. Me “V. M. A” është lidhur akt marrëveshje për pagesë detyrimesh, ku janë futur edhe detyrimet e qerasë, ku nuk ka paguar tarifën e qirasë të vitit 2022 prej 52,416 lekë dhe nuk ka paguar as për 2023 pasqyruar tek pagesat e debitoreve.
6. “A K” është njoftuar me shkresën me nr.181/1 prot datë 25.07.2023 për detyrim të hershëm kontraktor para 5 vitesh në vlerën 204,700 lekë, aktualisht nuk ka kontratë 3 vitet e fundit, pasi e ka aktivitetin e pezulluar.

Statusi i rekomandimit: **Në proces zbatimi.**

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, Bashkia Has ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Konstatohet se 6 subjekte nga 9 subjekte që kanë ushtruar aktivitet kanë paguar rregullisht detyrimin vjetor për autorizimin/licencën. Subjekti “D. H” shpk, të cilëve u ka përfunduar autorizimi më datë 17.11.2022 dhe “D. M”shpk në datën 28.03.2022 nuk janë pajisur me autorizim të ri nga Bashkia Has. Nisur nga të dhënat e dosjeve të subjekteve konstatohet se në 3 raste subjektet kanë mbyllur aktivitetin (“E”shpk në vlerën 100,000 lekë, “K. L”shpk në vlerën 707,000 lekë dhe “H”shpk në vlerën 200,000 lekë), të cilët nuk kanë paguar detyrimin deri në fund të vitit 2022 për vlerën 1,007,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për vitin 2022 në buxhetin e bashkisë Has.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, nenet 4,15 dhe 20/2” dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjekteve “D. H” shpk dhe “D. M” shpk të marrë masa, që këta subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Has për 5 vjet, duke filluar nga data e mbarimit në vitin 2022. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimsi

Komenti i grupit të auditimit.

Për subjektin “D. H” shpk është lëshuar autorizimi nr.2, datë 14.04.2023 “Për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe lëndëve djegëse (Gazit)” me afat të vlefshmerisë deri në datën 17.11.2024. Kjo për shkak se ky Autorizim është vijues i autorizimit nr.2, datë 18.11.2019 të lëshuar nga Bashkia Has për një periudhë 3-vjecare deri në datën 17.11.2022, i cili në fakt duhej të ishte 5-vjecare deri në datën 17.11.2024. Subjekti ka paguar nga data 18.11.2019 deri në datën 14.04.2023 shumën prej 800,000 leke. Sipas akt marreveshjes datë 14.04.2023 subjekti duhet të likujdoje brenda datës 14.04.2024 edhe shumën prej 200,000 lek, për afatin e autorizimit deri në datën 17.11.2024. Subjekti D. M. shpk ka autorizim për GAZ (Auto Gaz), nuk ka detyrime për vitet e tjera deri 30 korrik 2024.

Statusi i rekomandimit: **Pjesërisht**

10. Gjetje nga auditimi: Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Sektori i Financës i mungon libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese, çka tregon se veprimet me llogaritë nuk kanë ndjekur rrjedhën logjike kontabël për nxjerrjen e bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik” Kreu III, pika 3.2, nënpikat 43,44,45. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 46-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare duke ndjekur fazat në mënyrë llogjike, që nga mbajtja e dokumentave përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, të bëjë në fund kryerjen e veprimeve të mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has nuk ka marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare duke ndjekur fazat në mënyrë llogjike, që nga mbajtja e dokumentave përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, të bëjë në fund kryerjen e veprimeve të mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

Statusi i rekomandimit: **Pazbatuar.**

11. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2021 dhe në fund të vitit 2022. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 46-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin financiar të ish-komunës Gjinaj, mbi bazë të së cilës të analizojë dhe të përcaktojë të drejtat e konstatuara për arkëtim, duke përcaktuar personat përgjegjës material me shumat përkatëse që i kanë detyrim Bashkisë për kthim. Nëse është e pamundur Bashkia Has të ndjekë hapat ligjorë për njohjen ose jo të këtij detyrimi dhe më pas të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet.

Brenda datës 31.03.2024

Komenti i grupit të auditimit.

Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka shqyrtuar dokumentacionin financiar të ish-komunës Gjinaj, mbi bazë të së cilës duhet të analizonte dhe të përcaktonte të drejtat e konstatuara për arkëtim, duke përcaktuar personat përgjegjës materialet me shumat përkatëse që i kanë detyrim Bashkisë për kthim

Statusi i rekomandimit: **Pazbatuar**

12. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në fund të vitit 2022 , rezulton në vlerë neto 1,791,490 lekë dhe vlerë historike 9,729,027 lekë, që i përket 27 projekt-studimeve për investime të kryera në vitet e mëparshme, vlerë e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv apo në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “Aneksi 1. pika 2, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” Pika 3.3 nën-pika 62 dhe Kreu II,

pika 16/b.d (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 46-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës 1,791,490 lekë që i përket 27 projekt-studimeve sipas investimeve të kryera dhe për cdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Më pas të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

Brenda datës 31.03.2024

Komenti i grupit të auditimit.

Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka kryer veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës 1,791,490 lekë që i përket 27 projekt-studimeve sipas investimeve të kryera për cdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Statusi i rekomandimit: **Pazbatuar**

13. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 28,103,657 lekë, vlerë kjo, e cila nuk rakordon me shumën e gjendjeve të llogarisë analoge 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” në vlerën 28,103,657 lekë dhe llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” në vlerën 11,333,144 lekë të bilancit, pasi kjo gjendje duhet të pasqyrojë detyrimin e plotë, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, ndërkohë që vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2022 është 39,436,801 lekë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 46-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1 Rekomandim; Drejtoria e Buxhetit, Financës, Takasve dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve, që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës (llog.7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*”). Këto veprime të kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Brenda datës 31.03.2024

Komenti i grupit të auditimit.

Nga Bashkia Has sektori i financës janë kryer veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve, që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës (llog.7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*”).

Statusi i rekomandimit: **Në proces zbatimi**

14. Gjetje nga auditimi: Gjatë zhvillimit të të gjithë procedurave të prokurimit publik nga Bashkia Has për vitet 2021-2022 u vu re mungesa e hartimit të raporteve përmbledhëse. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 63-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 Rekomandimi: Bashkia Has, të marrë masa për shqyrtimin e kërkesave ligjore për hartimin e raporteve përmbledhëse gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Bashkia Has, nuk ka marrë asnjë masë për shqyrtimin e kërkesave ligjore për hartimin e raporteve përmbledhëse gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit

Statusi i rekomandimit: **Pazbatuar**

15. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha dosjet e audituara në Bashkinë Has për periudhën 2021-2022, vihet re se të gjitha shkresat që ndodhen në dosjet e prokurimit proces verbale, urdhra të Kryetarit për ngritjen e NJP, KVO, Vendime të Kryetarit etj, nuk kanë numër protokolli. Bashkia Has i regjistron urdhrat dhe vendimet në një regjistër elektronik që administrohet nga Zv/Kryetari i Bashkisë, ndërsa punonjësja e protokoll-arkivës nuk ka asnjë informacion lidhur me këto urdhra dhe vendime. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Vendimin nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” neni 4 Dokumentet administrative pika 1, Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 12, neni 13, neni 19. Gjithashtu, u evidentua se për asnjë dosje nuk është bërë inventarizimi dhe arkivimi, veprime këto në kundërshtim me kuadrin rregullator për arkivat dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, si dhe Urdhrit nr. 57, datë 12.06.2014, pika III, hapi 5. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 63-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Has të marrë masa të menjëhershme që shkresat e brendshme si urdhri apo vendimi etj të regjistrohen në regjistrin e korrespondencës si dhe të marrin numër protokolli dhe numrin e aktit në rastin konkret urdhër apo vendim i brendshëm. Gjithashtu, të marrë masa për arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të përfunduara dhe dosjeve që do të mbyllën në vijimësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit

Janë verifikuar urdhërat dhe vendimet te cilat janë regjistruar në regjistrin e korrespondencës si dhe janë konstatuar me numra protokolli.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar**

16. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë tek e cila nuk pasqyrohej dokumentacioni i plotë i pronësisë për të gjithë sipërfaqen që do të zhvillohet, në përputhje me dokumentacionin e paraqitur në lejen e zhvillimit dhe me planvendosjen e miratuar, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D.H ShPK dhe aplikues E/M, në fshatin "V", Has. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me VKM 408, Neni 15, pika 1.b), dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandim: Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë përpara miratimit të lejes së ndërtimit, në përputhje me lejen e zhvillimit dhe planvendosjen e propozuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi i lënë nga KLSH-ja, në Bashkinë Has me dokumentacionin e pronësisë përpara miratimit të lejes së ndërtimit

Statusi i rekomandimit: **Në proces zbatimi.**

17. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat nuk ishte konvertuar statusi i pronësisë nga tokë "arë" në tokë "truall", për të gjithë sipërfaqen e parcelës që do të zhvillohej ndërtimi, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe legjislacionin në fuqi, përkatësisht në lejet e ndërtimit të miratuar me objekt: 1."Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë

28/03/2022, me zhvillues D. H. ShPK dhe aplikues E/M, në fshatin"V.", Has dhe 2. "Objekt Banimi 2-katesh me papafingo", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë ,Has. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Vendim Nr. 440, datë 3.6.2020, pika 6, për kalimet dhe ndryshimet e kategorive të resurseve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandim: Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar statusin e pronësisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e njësisë përkatëse dhe konvertimin e të gjithë sipërfaqës së pasurisë në truall për të vijuar më tej me zhvillimin e ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit:Për sa më sipër trajtuar rekomandimi i lënë nga KLSH-ja, në Bashkinë Has e cila me kërkesën me nr. 997 prot, datë 05.06.2021, dërguar ASHK, kërkohet konvertimi i pasurisë me nr.106/1 zona kadastrale 2283 me sip 7800m2. Nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës zyra vendore Has ka ardhur konvertimi i kësaj parcele në datën 16.07.2021 me nr pasurie 106/2/3.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar**

18. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 4 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane, të tilla si koeficienti i shfrytëzimit të territorit, intensitetit të ndërtimit, lartësia e ndërtimit, të përcaktuara në Planit e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, përkatësisht në lejet e ndërtimit të miratuar me objekt: 1. : "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D. H. ShPK dhe aplikues E/M, në fshatin"Vranisht", Has; 2. "Shtesë anësore dhe 2-kat në lartësi në ndërtimin ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 18, datë 26/08/2021, me zhvillues A. Sh. dhe aplikues T. Ç., Krumë ,Has; 3. "Projekt zbatim për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 26, datë 20/05/2022, me zhvillues Q. P. dhe aplikues Dh.P., Rruga e Kukësit, Has; 4. "Objekt Banimi 2-katesh me papafingo" për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me **Ligjin 107, Neni 20** , Plani i Përgjithshëm Vendor, me **VKM-së 408, Neni 32, Kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie, pika 1, me VKM-së 408, Neni 38, Intensiteti i ndërtimit, me VKM-së 408, Neni 39, Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim, me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).***

18.1 Rekomandim: Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar të gjitha materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, dokumentacionin e pronësisë, planvendosjen me të gjithë elementët përbërës të saj, projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi i lënë nga KLSH-ja, në Bashkinë Has

Statusi i rekomandimit: **Në proces zbatimi.**

19. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat evidentohet e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitjen në planvendosje të distancës nga kufiri i pronës dhe mosrespektimi i distancave të objektit nga kufiri i pronës, përkatësisht në lejet e ndërtimit të miratuar me objekt:1. "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me

Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D. H. ShPK dhe aplikues E/M, në fshatin "Vranisht", Has; 2. "Shtesë anësore dhe 2 kat në lartësi në ndërtimin ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr.18, datë 26/08/2021, me zhvillues A. Sh. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has; 3. "Objekt Banimi 2-katesh me papafingo" për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me **VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, neni 35**, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandim: Nga DPZHT Has të merren masa që të verifikohen pasqyrimi i distancave ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës në planvendosjen e miratuar, si edhe distancat të jenë në përputhje me distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi i lënë nga KLSH-ja, në Bashkinë Has ku janë pasqyruar distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar.**

20. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat evidentohet e njëjta situatë, në lidhje me mospërcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe respektimin e distancave midis ndërtimeve, në bazë të legjislacionit në fuqi, përkatësisht në lejet e ndërtimit të miratuar me objekt: 1. "Projekt-zbatim për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 26, datë 20/05/2022, me zhvillues Q. P. dhe aplikues Dh. P., Rruga e Kukësit, Has; 2. "Shtesë anësore dhe 2-kat në lartësi në ndërtimin ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 18, datë 26/08/2021, me zhvillues A. Sh. dhe aplikues T. Ç., Krumë. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me **VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, Neni 37**, lartësia e ndërtimeve dhe me **VKM 408, Neni 34**, distancat minimale midis ndërtimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandim: Nga DPZHT Has të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në lidhje me përcaktimin e numrit të kateve të objektit, duke i verifikuar me projektin e ndërtimit dhe respektimin e distancave ndërmjet ndërtimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi i lënë nga KLSH-ja, në Bashkinë Has duke dorëzuar subjekti plan vendosjen e miratuar të vitit 2021.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar.**

21. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktika tek e cila nuk pasqyrohet e saktë distanca ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës, duke krijuar hapësirë për të mos respektuar distancën minimale të lejuar, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: "Projekt-zbatim për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues" me zhvillues Q. P dhe aplikues Dh. P, Rruga e Kukësit, Has. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me **VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, neni 36**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1 Rekomandim: Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar në planvendosje paraqitjen e të gjitha distancave të nevojshme që nevojiten të respektohen ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi i lënë nga KLSH-ja, në Bashkinë Has e cila ka dorëzuar plan vendosjen e vitit 2022 me paraqitjen e të gjitha distancave të nevojshme
Statusi i rekomandimit: **Zbatuar.**

22. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek e cila tipologjia e ndërtimit dhe e objektit nuk ishte në përputhshmëri me tipologjinë e ndërtimit të lejuar në zonë , përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: “Ambjente shërbimi, punime dhe infrastrukture mbeshtetese per pemtoren me arra”, për të cilën është marrë vendimi me Nr. 23, datë 16/03/2022, me zhvillues K. C. ShPK dhe aplikues K P, Fshati Helshan, Has. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, Nenit 14 dhe me kontratën e qirasë "Për dhënien me qira të tokës bujqësore(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1 Rekomandim: Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar projektin e ndërtimit, në përputhje me kondicionet urbane të lejuara në zonë dhe në përputhje me të gjithë dokumentacionin e ngarkuar në sistem, duke përfshirë edhe marrëveshjet dhe kontratat e qirave. Nëse evidentohet mospërputhshmëri ndërmjet projektit të miratuar dhe kushteve të kontratës së qirasë, të rishikohet vlefshmëria e kontratës për dhënien me qira të tokës bujqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi i lënë nga KLSH-ja, në Bashkinë Has nga DPZHT ka dërguar shkresën me nr. prot 80 datë 01.02.2022 Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ku kërkohet vlerësimi i tyre për “Ambjente shërbimi” me vendodhje fshati Helshan Bashkia Has, me zhvillues shoqërinë “K. C.” dhe me shkresën me nr 1013 datë 15.02.2022 e cila kërkon treguesit e distancave në planvendosjen e objektit nga ana e bashkise Has është hartuar plan vendosja e vitit 2022.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar.**

23. Gjetje nga auditimi: Në njoftimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk paraqitet mënyra e për llogaritjes së saj, e evidentuar në të gjitha lejet e ndërtimit të miratuara. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me **Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006** "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit Bashkiak Has. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1 Rekomandim: Nga Bashkia Has të merren masa për të pasqyruar në njoftimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë mënyrën e përlllogaritjes së taksës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.Nga Bashkia Has nuk janë marrë masa për të pasqyruar në njoftimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë mënyrën e përlllogaritjes së taksës.

Statusi i rekomandimit: **Pazbatuar**

24. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Has për vitin 2022 struktura e IMTV-së nuk ka qenë funksionale. Kjo vjen si rezultat i mungesës së një Sektori të Mbrojtjes së Territorit dhe mungesës së Kryeinspektorit. Në strukturën e vitit 2022 janë 2 punonjës të emëruar në pozicionin e Inspektorit të Terrenit, 1 në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës dhe 1 në NjA Golaj. Inspektorët nuk kanë plane pune mujore ku të jetë parashikuar edhe mbikëqyrja që ato duhet të bëjnë në vazhdimësi për zbatimin e kushteve të lejeve të dhëna nga bashkia. Bashkia Has nuk ka blloqe që të kenë një numër serial të fletëve për procesverbalet që

mban në rastet e konstatimit të kundërvajtjes, të marrjes së masës së pezullimit të punimeve apo të marrjes së masës së prishjes së ndërtimit. Proces verbalet e konstatimit të kundërvajtjes janë një model që inspektorët i printojnë rast pas rasti dhe i plotësojnë kur janë në terren. Gjatë inspektiveve në terren janë mbajtur proces verbale dhe janë vendosur gjopa vetëm me firmën e një inspektori. Nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Has nuk mund të vendosen gjopa apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 13 pika 1/b/ii, pika 1/c/i, pika 4. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 122-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Has të marrë të gjitha masat për të plotësuar strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit. Kryeinspektori të marrë masat e nevojshme për të hartuar planet mujore të punës ku të parashikohet edhe mbikëqyrja që ato duhet të bëjnë në vazhdimësi për zbatimin e kushteve të lejeve të dhëna nga bashkia. Kryeinspektori të marrë masa që të verifikohen në terren të gjitha proces verbalet që janë mbajtur vetëm me firmën e një inspektori. Në përfundim të këtyre verifikimeve të merren masat administrative përkatëse për të gjithë kundërvajtësit. Kryeinspektori të marrë masat që për inspektimet që do të kryhen të përdoren dokumentet e dhura duke filluar nga procesverbalet që mbahen në rastet e konstatimit të kundërvajtjes, për pezullimin e punimeve, për prishjen e ndërtimit apo në rastet e vendosjes së gjobave. Këto dokumente të kenë një numër serial të fletëve duke zvogëluar mundësinë për gabime apo abuzime.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Me urdhërin nr. prot. 581 datë 22,06,2023 për ndryshime në strukturën e Bashkisë Has, rezulton se në Bashkinë Has struktura ka një Kryeinspektor territori, një Inspektor territori Njësia Golaj, Një Inspektor territori Njësia Fajzë dhe Një Inspektor territori në Njesine Gjinaj. Vende vakante nuk ka.

Statusi i rekomandimit: **Zbatuar**

25. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has nuk ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH si dhe nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa për të hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lënë nga KLSH, si dhe të kryej raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Me shkresën me nr.prot.1082/1 e datës 30.05.2023 është hartuar plani i veprimit i dërguar KLSH-së por nuk është zbatuar afati 6 mujor për informim të KLSH^{së}, në zbatim përkatësisht të

nenit 15 gërma “j”, dhe nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizmin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Statusi i rekomandimit: **Pjesërisht.**

26. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has nga auditimi i ushtruar në vitin 2022 nuk ka zbatuar masat e lëna si më poshtë:

- Nga 13 masa organizative janë zbatuar 3 masa (rekomandimet 8.1, 9.1, 11.1) dhe nuk janë zbatuar 10 masa organizative (rekomandimet 1.1, 2.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 7.1, 10.1, 12.1, 13.1);
- Nga 2 masa për shpërblim dëmi, rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar, ndërsa 2.1 nuk është pranuar dhe as nuk është zbatuar;
- Nga 6 masa për uljen e borxhit tatimor nuk është pranuar 1 masë (rekomandimi 3.1), nuk janë zbatuar 2 masa (rekomandimet 5.1, 6.1) si dhe janë në proces zbatimi 3 masa (rekomandimet 1.1, 2.1, 4.1). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e realizuar në vitin 2022.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti i grupit të auditimit.

Bashkia Has nuk ka marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e realizuar në vitin 2021.

Statusi i rekomandimit: **Pazbatuar**

27. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i ankesë së paraqitur në KLSH lidhur me vendosjen e bustit të Pjetër Bogdanit rezulton se:

- Projekti është planifikuar me bashkëfinancim nga fondet e Bashkisë Has (*bazamenti*) dhe nga donatorë (*busti*).
- Nuk ka një vlerë totale të veprës për të llogaritur se sa % është financuar nga Bashkia Has dhe sa % nga donatorët. Dihet vetëm vlera që bashkia ka investuar për bazamentin (794,000 lekë pa TVSH dhe 952,800 lekë me TVSH).
- Lidhur me financimin e bustit që është bërë nga donatorë privatë nuk ka dokumentacion se sa ka qenë vlera e tij dhe nuk është dokumentuar procesi.
- Në dokumentacionin e audituar nuk është identifikuar se kush është donatori. Nuk ka asnjë korrespondencë shkresore midis Bashkisë Has dhe donatorit. Strukturat e bashkisë deklarojnë se komunikimi për këtë projekt ka qenë verbal.
- Busti i dhuruar nuk është shoqëruar me dokumentacionin përkatës, në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 57.
- Investimi i bërë nga bashkia (bazamenti) nuk është bërë hyrje nga Bashkia Has por është klasifikuar si shpenzim në zërin 602. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 143-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Has të ngrëjë një grup pune për të verifikuar dhe dokumentuar procesin e ndjekur për vendosjen e bustit të Pjetër Bogdanit si dhe të merren masa për të plotësuar dokumentacionin me qëllim vlerësimin e veprës dhe regjistrimin e saj në inventarin e Bashkisë Has.

Komenti i grupit të auditimit.

Nuk është ngritur grup pune për të verifikuar dhe dokumentuar procesin e ndjekur për vendosjen e bustit të Pjetër Bogdanit.

Statusi i rekomandimit: **Pazbatuar**

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përlogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur, në bazë të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt: “Ambjente shërbimi, punime dhe infrastrukture mbështetese për pemtoren me arra”, për të cilën është marrë vendimi me Nr. 23, datë 16/03/2022, me zhvillues K. C. ShPK dhe aplikues K. P., Fshati Helshan, Has, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **265,845.521 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46 dhe ligjit Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Nga Bashkia Has të merren masa për arkëtimin e vlerave që përbëjnë një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përlogaritjes së pasaktë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.

1.2 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Has të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **265,845.521 lekë**, nga subjekti "K. C." ShPK, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Deri më 31.12.2023

Komenti i grupit të auditimit.

Nga Bashkia Has nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e vlerave që përbëjnë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Statusi i rekomandimit: **Pazbatuar.**

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.1 Gjetje nga auditimi: Nga auditimin e 6 procedurave të prokurimit për vitin 2021 me vlerë të fondit limit 21,878,340 lekë pa TVSh, ka rezultuar se në të 6 procedurat janë konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimet publike. Në këto 6 procedura ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të dokumenteve të tenderit, si dhe përmendja e markës së prodhimit në preventivin e artikujve në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 21,878,340 lekë, si vijon:

1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Karburanti për Mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave të Bashkisë Has” viti 2021, me fond limit 5,041,667 lekë pa TVSh, me fitues OE “V. P.” ShPK, me vlerë oferte 5,041,667 lekë pa TVSh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 5,041,667 lekë pa TVSh;

2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “K” viti 2021, me fond limit 1,761,345 lekë pa TVSh, me fitues OE “B. H” ShPK, me vlerë oferte 1,761,345 lekë pa TVSh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos

plotësimi të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 1,761,345 lekë pa TVSh, si dhe rezulton se Njësia e Prokurimit gjatë hartimit të preventivit me artikujt ushqimorë, si orizi, njësia matëse e salcës për formatin e ambalazhimit, vaji dhe vezët ka përmendur markën e prodhimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin Publik”, neni 36, pika 4;

3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujëmbledhësve” viti 2021, me fond limit 4,467,291 lekë pa TVSh, me fitues OE “Z” ShPK, me vlerë oferte 4,467,291 lekë pa TVSh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimi të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 4,467,291 lekë pa TVSh;

4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime” viti 2021, me fond limit 5,740,833 lekë pa TVSh, me fitues BOE “D” ShPK dhe “Xh” ShPK, me vlerë oferte 5,740,833 lekë pa TVSh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimi të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 5,740,833 lekë pa TVSh;

5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore” viti 2021, me fond limit 2,527,900 lekë pa TVSh, me fitues OE “D. H” ShPK, me vlerë oferte 2,527,900 lekë pa TVSh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimi të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 2,527,900 lekë pa TVSh;

6. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë” viti 2021, me fond limit 2,339,304 lekë pa TVSh, me fitues OE “V. G.” ShPK, me vlerë oferte 2,339,304 lekë pa TVSh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimi të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 2,339,304 lekë pa TVSh.

1.2 Gjetje nga auditimi: Nga auditimin i 8 procedurave të prokurimit për vitin 2022 me vlerë totale të fondit limit 41,707,499 lekë pa TVSh, kanë rezultuar me shkelje të kuadrit ligjor për prokurimin publik 6 procedura me vlerë totale të fondit limit 29,866,666 lekë pa TVSh ose 72% e fondit limit. Përkatësisht, shkelje janë konstatuar në hartimin e fondit limit dhe të preventivit të punimeve në 5 procedura. Në hartimin e kriterëve të vendosura jo në përputhje me objektin e kontratës si dhe nuk është bërë argumentimi i tyre në rastin e 3 procedurave. Janë kualifikuar OE të cilët nuk i plotësojnë kriteret e vendosura në DT dhe kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur në 6 procedura, përkatësisht si vijon:

1. Procedura e prokurimit me objekt: “Pastrimi i kanaleve ujitëse, kryesore dhe dytësore të ujëmbledhësve”, Fondi Limit 5,333,333.0 lekë pa TVSH. Ka ndryshime në zërat e punimeve nga procesverbali që është mbajtur për hartimin e fondit limit me preventivin e punimeve. Komisioni i hartimit të Fondit dhe Njësia e Prokurimit nuk kanë argumentuar dhe dokumentuar ndryshimet e bëra në zërat e punimeve dhe çfarë ndikimi kanë këto në realizimin e kontratës. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE V. G. SHPK, & I. G. SHPK me vlerë oferte 4,783,363.0 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

2. Procedura e prokurimit me objekt: *“Rehabilitim dhe pastrim i sipërfaqe pyjore”*, Fondi Limit 1,833,333 lekë pa TVSH. Njësia e Prokurimit nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë hartimit të kriterëve për kualifikim duke vendosur kriterë të pa argumentuara. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "L" SHPK, & "D. C." SHPK, me vlerë oferte 1,629,450 lekë pa TVSH në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.

3. Procedura e prokurimit me objekt: *“Ndërtim KUZ, Fshati Gajrep, Krumë, Golaj”*, Fondi Limit 5,500,000.0 lekë pa TVSH. Nuk është argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritja e vlerës së kontratës. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “V. G.” SHPK & “A.2. C” SHPK me vlerë oferte 4,948,900.0 lekë pa TVSH, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.

4. Procedura e prokurimit me objekt: *“Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore”*, Bashkia Has, Fondi Limit 3,000,000 lekë pa TVSH. Ka pasaktësi në përlllogaritja e vlerës së fondit limit dhe ndryshim i zërave të punimeve nga proces verbali i hartimit të fondit limit në preventivin e punimeve. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "H-G. C." SHPK, dhe “C” SHPK, me vlerë oferte 2,490,953.0 pa TVSH, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.

5. Procedura e prokurimit me objekt: *“Rikonstruksion i ambienteve të brendshme, ish shkolla mesme Krume- Kati I-rë (Teknik), në funksion të kopshtit të fëmijëve Qyteti Krumë”*, Fondi Limit 4,200,000.0 lekë pa TVSH. Nuk është argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritja e vlerës së fondit limit. Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit nuk ka dokumentuar llogaritjen e vlerës për 34 zëra punimesh. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "D.-G" SHPK me vlerë oferte 4,017,950.0 lekë pa TVSH, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.

6. Procedura e prokurimit me objekt: *“Blerje Automjet Teknologjik (kamion) për Grumbullim-Kompaktim-Shkarkim të mbeturinave”*, Fondi Limit 10,000,000 lekë pa TVSH. Nuk është argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritja e vlerës së kontratës. Komisioni nuk ka argumentuar vlerat e parashikuara për blerjen e automjetit dhe të konteinerëve. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "T" SHPK, me vlerë oferte 9,729,540.0 lekë pa TVSH, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 63-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1-1.2/1 Rekomandim: Titullari i AK të marrë masa që Komisioni për Hartimin e Fondit Limit të argumentojë zërat e punimeve, volumin dhe vlerën e tyre me qëllim shmangien e ndryshimit të pa argumentuar gjatë hartimit dhe miratimit të preventivit të punimeve.

1.1-1.2/2 Rekomandim: Titullari i AK duhet të marrë masa që NJP në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specifikime teknike që janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar.

1.1-1.2/3 Rekomandim: Titullari i AK dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të kualifikimit të OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë. Gjithashtu, të bëhet argumentimi i saktë i skualifikimit apo kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit_ **Në proces zbatimi**

D. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, neni 59 *“Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”*, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*,

ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Has t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Komenti i grupit të auditimit.

Nga Bashkia Has nuk është marrë asnjë masë për Komisionin Disiplinor t’i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Has dhënien e masave disiplinore

Statusi i rekomandimit: **Pa zbatuar**

IV.GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Has nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me nenin 8 pikën 8/a të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Megjithëse nga titullari i Bashkisë Has është ngritur Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA-së 2024-2026, por këtu nuk janë reflektuar ndryshimet e ndodhura nga zgjedhjet e pushtetit vendor përgjatë muajit qershor 2023 që ka bërë të ketë lëvizje të punonjësve, si dhe nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK.

Megjithëse Bashkia Has e kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme, e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak datë 03/01/2019 “Rregullore e funksionimit të brendshëm administrativ të Bashkisë Has”, nuk disponon përkrahje pune, dhe procedura e ndjekur për hartimin e tyre nuk është bërë në përputhje me nenin 24 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përkrahimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.

Nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve, sikurse përcaktohet në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” Gjithashtu, Bashkia Has nuk disponon një program trajnimi për punonjësit por janë dërguar nevojat për trajnim.

Bashkia Has nuk ka hartuar një strategji risku, nuk ka hartuar regjistër risku, si dhe nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk, veprime në kundërshtim me nenin 12 pika dhe nenin 21 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Titullari i Bashkisë Has për vitin 2023 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK. Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.

Nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk është hartuar plani vjetor i trajnimeve në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe

“Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1 faqe 15-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Has të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së riskut, të miratojë gjurmën e auditimit për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.

Koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën të informacioneve cilësore për vlerësimin e progresit të bërë nga njësia në arritjen e objektivave të MFK-së. Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has të marrë masat për hartimin e planit vjetor të trajnimeve të punonjësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has ka ngritur NJAB për vitin 2023, e cila ka funksionuar me 1 auditues sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Kryetari i Bashkisë me Vendimin të KB nr. 95 datë 01.01.2023 *“Struktura organizative e miratuar”* (e ndryshuar). Ndërsa me VKB nr. 581, datë 22.06.2023 struktura e Njesisë së Auditit të Brendshëm është përcaktuar me 1 përgjegjës dhe 2 specialist audit, por në fakt nuk është e plotësuar deri tani. Plani i auditimeve për vitin 2023 është 6 angazhime auditimi, por në fakt janë realizuar 3 auditime, pra në masën 50%.

Nga auditimi i tre dosjeve të angazhimeve u konstatuan mangësi: dosjet janë jo të plota dhe të pa inventarizuara. Në dosje gjenden vetëm programet e angazhimit të auditimit; autorizimet për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit; njoftimin për fillimin e angazhimit si dhe Raporti përfundimtar i auditimit që në të tre rastet është i pa nënshkruar nga audituesi. Pra i gjithë dokumentacioni tjetër pjesë e domosdoshme e dosjes mungon. Nga NJAB nuk janë dërguar shkresa njëjshive të audituara për të kërkuar informacion mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna dhe në auditimin e radhës çështja e zbatimit të rekomandimeve duhet të trajtohet si çështje kryesore.

Veprime dhe mos veprime në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 *“Për Auditimin në Sektorin Publik”* në nenet 2,5 dhe 6 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2 faqe 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakant në strukturën e Njesisë së Auditit të Brendshëm, me qëllim bërjen funksionale të kësaj njësie auditimi për përmbushjen e misionit të saj, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë.

2.2 Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm, në periudhën në vijim të marrë masa për realizimin e misioneve të planifikuara, si dhe planifikimin e misioneve me risk që kjo njësi vendore ka deri në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi evidentohen risqe buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara dhe mos likuidimi i vendimeve gjyqësore, rezulton se vlera e faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2022 është prej 11,333 mijë lekë. Janë krijuara gjatë vitit 2023 detyrime në vlerën 6,854 mijë lekë dhe është likuiduar në vlerën 17,601 mijë lekë, duke rezultuar gjendje më 31.12.2023 në vlerën 587 mijë lekë, veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 *“Për financat e qeverisjes vendore”*, neni 34, pika 1, neni 40, pika 3, Udhëzim i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, pika 101. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 25-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë

Has, të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 587 mijë lekë, duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim, si dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Sektori i Financës i mungon libri i madh apo libri centralizatori për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese, çka tregon se veprimet me llogaritë nuk kanë ndjekur rrjedhën logjike kontabël për nxjerrjen e bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik” Kreu III, pika 3.2, nënpikat 43,44,45. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 38-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has të marrë masa, që në hartimin e pasqyrave financiare, të mbështetet në normat dhe parimet e kontabilitetit, në rregullat për dokumentacionin si dhe në procedurat për mbajtjen kronologjike të kontabilitetit, duke u finalizuar me përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të Bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2022. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 38-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin financiar të ish-komunës Gjinaj, mbi bazë të së cilës të analizojë dhe të përcaktojë të drejtat e konstatuara për arkëtim në vlerën 914,949 lekë, duke përcaktuar personat përgjegjës material me shumat përkatëse, që i kanë detyrim Bashkisë për kthim. Nëse është e pamundur Bashkia Has të ndjekë hapat ligjorë për njohjen ose jo të këtij detyrimi dhe më pas të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

6. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në fund të vitit 2023, rezulton në vlerë neto 1,791,490 lekë dhe vlerë historike 9,960,627 lekë, që i përket 27 projekt-studimeve për investime të kryera në vitet e mëparshme, vlerë e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv apo në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë.

Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1. pika 2, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” Pika 3.3 nënpika 62 dhe Kreu II, pika 16/b.d (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 38-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtorja e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës 1,791,490 lekë që i përket 27 projekt-studimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Më pas të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

7. Gjetje nga auditimi: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) të klasës 21 për vitin 2023 është në vlerën 3,211,522,798 lekë, ku janë pasqyruar të gjitha lëvizjet e aktiveve gjatë vitit 2023 për shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivi. Në inventarët kontabël të aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 1,074,183 lekë; 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 966,447,807 lekë; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,627,644,078 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 75,859,409 lekë janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera gjatë vitit 2023 për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Për vitin 2023 nuk është kryer inventari fizik i aktiveve materiale dhe jo materiale si dhe aktiveve afatshkurtra të Bashkisë Has dhe 4 NJA-ve, duke mos ushtruar kontroll të paktën një herë në vit mbi aktivet dhe menaxhimin e tyre në lidhje me vërtetimin e saktësisë, cilësisë e gjendjes fizike të tyre për shmangien e humbjeve apo keqmenaxhim e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar kapitulli III, pika 30, Kreu IV. “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pikat 73,74, me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 38-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Has dhe Drejtorja e Financës, Buxhetit dhe Taksave Vendore të marrin masa për kryerjen e procedurave të inventarizimit fizik të aktiveve të paktën një herë në vit, si dhe të bëhen sistemimet e nevojshme lidhur me ndryshimet e konstatuara nga inventari kontabël, të kryhen përditësimet në kontabilitet duke plotësuar dhe saktësuar regjistrin historik të aktiveve.

Brenda datës 31.12.2024

8. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën prej 18,586,594 lekë, vlerë e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në vlerën 19,759,878 lekë të aktivitetit të bilancit, pasi kjo gjendje duhet të pasqyrohet detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Aneksi 1 pika 3.3, nënpika 8 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 38-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e detyrimeve, që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës (llog.7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*”).

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 69,067,839 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 70,461,012 lekë. Referuar analizës së llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” dhe lëvizjeve shtesa-pakësime nga viti 2022 në vitin 2023 konstatohet se, vlera e shtuar e debitorëve në vitin 2023 për taksën e infrastrukturës prej 1,729,423 lekë nuk është përfshirë në gjendjen e kësaj llogarie në mbyllje të vitit 2023, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, Kreu III. “*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, pika 32 Aneksi 1 “*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*”, Pika 3.3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 38-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të listave të inventarëve të aseteve rezultoi se, janë 1444 prona të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Has (Qendër), listat përfundimtare të të cilave janë të miratuara me VKM-ët përkatëse, ndërsa për 412 prona të 3 Njësi Administrative si **Golaj e Fajza** janë në fazën e miratimit të listave paraprake dhe **Gjinaj** në fazën fillestare.

Nga këto prona janë hipotekuar 20 pasuri të paluajtshme dhe janë në proces aplikimi për certifikim hipotekor 26 pasuri të tjera. Për pjesën tjetër të pronave nuk është bërë përditësimi i të dhënave të inventarit të këtyre pronave.

Në mungesë përditësimit të inventarëve dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të këtyre pronave, për një pjesë nuk disponohet informacion në lidhje me gjendjen reale dhe statusin e tyre, sa nga këto prona janë të zëna, sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

Mos kryerja e procedurave për mos përditësimin e listave paraprake dhe fillestare të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM për 3 NJA **Golaj e Fajza** dhe **Gjinaj**, më pas paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e të dhënave të listë-inventarëve të pronave, mos regjistrimi në ASHK në favor të Bashkisë i pjesës më të madhe të këtyre pronave të listuar, si dhe mos vlerësimi i tyre janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*”, pikën 18,22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “*Për*

përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 55-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Bashkia Has nëpërmjet strukturave drejtuese dhe përgjegjëse të kryejë procedurat e plota për transferimin përfundimtar të listave të inventarëve të pronave për 3 NJA Golaj, Fajza dhe Gjinaj, duke kryer inventarizimin dhe përditësimin e listave paraprake të pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe më pas miratimi me VKB e paraqitja pranë ASHK në Drejtorinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike me vërejtjet dhe ndryshimet e listave të paraprake apo fillestare të pronave të miratuara. Gjithashtu për pjesën tjetër të pronave të kaluara Bashkisë me VKM në pronësi/përdorim, të pa hipotekuar të përgatisë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të ndjekë deri në fund regjistrimin e tyre në ASHK, Drejtoria Vendore Has.

Brenda datës 31.12.2024

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën 24/6 datë 06.04.2023 rezulton se, nga subjekti është respektuar afati **20 ditë** për kthimin e përgjigjes për marrjen e masave në zbatimin e rekomandimeve, përcjellë me shkresën nr. 1082/1 Prot, datë 30.05.2023, në zbatim të shkronjës “j” të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”.

Ndërsa për respektimin e afatit 6 mujorë nga Bashkia Has nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim të pikës 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”.

- Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a- Nga **23 masa organizative** të rekomanduara, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 7 masa, janë në proces 3 masa, **janë pjesërisht të zbatuara 2 masa dhe nuk janë zbatuar 11 masa.**

b- Nga **1 masë shpërblim dëmi** në vlerën **265,845.521 lekë**, pranuar 100% nga subjekti, e cila rezulton e pazbatuar.

c- Nga **3 masa për eliminim e efekteve negative**, pranuar 100% nga subjekti, të cilat janë në proces zbatimi.

d- Nga **4 masa për uljen e borxhit tatimor**, pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, në proces zbatimi janë 1 masë, **realizuar pjesërisht 2 masa dhe pa zbatuar 1 masë.**

e- **Masat disiplinore**, nuk janë dhënë nga titullari i institucionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 62-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

A. Masat Organizative

1.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa që hartohet dhe miratohet strategjia e rrishtit. Titullari i Bashkisë Has të miratojë gjurmën e auditimit për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të

rëndësishme. Koordinator i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën dhe formën e duhur të informacioneve cilësore me qëllim vlerësimin e progresit të bërë në arritjen e objektivave të MFK-së. Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has të marrë masa që për çdo largim punonjësish nga puna të ndiqet procedura për dorëzimin e detyrës.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa për ngritjen e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si dhe një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njesisë ose, shërbimi i auditit të brendshëm të kryhet nga njësia e auditit të brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse.

3.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Has dhe Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Has dhe kontraktorëve, brenda afatit 30 ditor pas ardhjes së faturës tatimore, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.

5.1 Rekomandim: Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për krijimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

6.1 Rekomandim: Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare duke ndjekur fazat në mënyrë logjike, që nga mbajtja e dokumentave përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatëse kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, të bëjë në fund kryerjen e veprimeve të mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit

11.1 Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin financiar të ish-komunës Gjinaj, mbi bazë të së cilës të analizojë dhe të përcaktojë të drejtat e konstatuara për arkëtim, duke përcaktuar personat përgjegjës material me shumat përkatëse që i kanë detyrim Bashkisë për kthim. Nëse është e pamundur Bashkia Has të ndjekë hapat ligjorë për njohjen ose jo të këtij detyrimi dhe më pas të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet.

12.1 Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës 1,791,490 lekë që i përket 27 projekt-studimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Më pas të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

14.1 Rekomandimi: Bashkia Has, të marrë masa për shqyrtimin e kërkesave ligjore për hartimin e raporteve përmbledhëse gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

23.1 Rekomandim: Nga Bashkia Has të merren masa për të pasqyruar në njoftimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë mënyrën e përllogaritjes së taksës.

25.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masa për të hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lënë nga KLSH, si dhe të kryej raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

26.1 Rekomandimi: Bashkia Has të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e realizuar në vitin 2022.

27.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Has të ngrëjë një grup pune për të verifikuar dhe dokumentuar procesin e ndjekur për vendosjen e bustit të Pjetër Bogdanit si dhe të merren masa për të plotësuar dokumentacionin me qëllim vlerësimin e veprës dhe regjistrimin e saj në inventarin e Bashkisë Has.

B. Masa shpërblim dëmi

1.2 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Has të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **265,845.521 lekë**, nga subjekti "K. C. 2020" ShPK, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

C.2 Masa për uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

4.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive **42,557,390 lekë** e përbërë nga:

- 26,825,739 lekë për 187 subjekte private (biznesi i madh dhe i vogël);
- 4,861,266 lekë për qiratë e ambienteve të tregut (Markat e Qytetit Krume);
- 10,619,005 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet;
- 96,900 lekë nga kontratat e dhënies me qira të aseteve;
- 154,480 lekë nga institucione publike;

7.1 Rekomandim: Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Has të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 276 debitorë në vlerën **10,620,347 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtime të reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Has të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

9.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjekteve "D. H" shpk dhe "D. M." shpk të marrë masa, që këta subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur prej **1,000,000 lekë** ndaj Bashkisë Has për 5 vjet, duke filluar nga data e mbarimit në vitin 2022. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIM E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të korrespondencës zyrtare të bashkisë me ASHK- Drejtoria Has dhe pagesat e kryera nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë (TNI) rezulton se, për vitin 2023 janë legalizuar 24 objekte me vlerë të TNI prej 1,068,602 lekë dhe në 6-mujorin e dytë të vitit 2022 (me shpresë të ardhur në 2023) janë legalizuar 15 objekte me vlerë të TNI prej 660,821 lekë. **Pra vlera totale e shtuar për vitin 2023 për taksën në infrastrukturë është 1,729,423 lekë**, për të cilën nuk është kryer asnjë pagesë, duke sjellë të ardhura të munguara (e pa kontabilizuar).

Ndërsa në vitet e mëparshme deri në Qershor 2022 janë 266 debitorë në vlerë totale 10,313,690 lekë, vlerë e cila është trajtuar në detyrimet për taksat dhe tarifave.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5. Pika 5 e nenit 27 të ligjit 9632 datë 30.10.2006 “për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 32-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë **1,729,423 lekë**.

Brenda datës 31.12.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë **9 subjekte** që ushtrojnë aktivitetet tregtim lëndë djegëse me pakicë, nga të cilat 1 pikë ka licenca me afat më të shkurtër se 5 vjet dhe me pagesa pjesore dhe 8 pika kanë licenca 5-vjeçare. Të 9 subjektet kanë detyrime me një efekt financiar me vlerë totale 4,447,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Has (e pakontabilizuar), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 32-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Taksave, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa që **9 subjektet** të plotësojnë dokumentacionin të bëjnë pagesën përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Has me vlerë **4,447,000 lekë**. Gjithashtu, Drejtoria e Financës dhe Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

Brenda datës 31.12.2024

D. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET KONTRAKTORE NGA OIRADHËNIA.

1.Gjetje nga auditimi: Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifën e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit. Bashkia Has nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësive administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitorë nuk ka një regjistër.

Si rezultat, procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitorë dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë.

Gjendja e debitorëve progresiv të vitit 2022 rezulton në vlerën 42,557,390 lekë, gjatë vitit 2023

janë paguar detyrime në total në vlerën 1,657,558 lekë dhe nga shtesat në vlerën 3,102,436 lekë, rezulton gjendja e debitorëve progresiv është në vlerën **44,002,268 lekë**.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e VKB nr. 78, datë 22.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has”, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 32-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Taksave, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2023 në vlerën progresive **44,002,268 lekë** e përbërë nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifave për biznesin e vogël në shumën 12,652,282 lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifave për biznesin e madh në shumën 15,200,476 lekë;
- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 206,600 lekë;
- Detyrime nga Kryefamiljarë të pajisur me leje legalizimi në shumën 10,313,690 lekë;
- Detyrime nga qiratë e tregut (markata) në shumën 5,357,075 lekë;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë në vlerën 272,145 lekë.

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Has, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje e lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Brenda datës 31.12.2024

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Has në kuadër të administrimit të aseteve për krijimin e të ardhurave ka lidhur **28 kontrata** përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik për dhënien me qira të aseteve, që ka në pronësi apo në përdorim për afate kohore nga 1-30 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, për aktivitet bujqësor, për pemëtari, antena, studim-kërkim-zbulim minerali dhe ngritje fabrike përpunimi, agroturizmit etj. Nga verifikimi i dokumentacioni e dosjeve të kontratave dhe pagesave të kryera rezultoi se, në fund të vitit 2023 paraqiten 10 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën 1,207,337 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has.

Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së dhe dokumentacionit të aseteve, rezultoi se në territorin e Bashkisë Has ushtrojnë aktivitetin **19 subjekte** private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullimos, asete të Bashkisë Has.

Nga Bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Has. Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së

Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” me VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore” i ndryshuar me VKM nr.267, datë 27.04.2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 55-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për monitorimin e kushteve të kontratave të qiramarrësve, duke e dokumentuar këtë proces, si dhe të veprojë në kohë ndaj të gjithë qiramarrësve që nuk respektojnë përcaktimet në kontratë. Të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e tarifës së qirasë nga 10 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në vlerën **1,207,337 lekë** (sipas tabelës të paraqitur në Raport Auditimi).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse Bashkia HAS, të marrë masa që për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të hartojë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pazbritura nga fondi pyjor, t’i drejtohet subjekteve me leje minerale të bëjë kërkesën për zbritje nga fondi pyjorë, në referencë të nenit 17, të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjorë”, i ndryshuar, për zbritjen nga fondi pyjorë. Gjithashtu në bashkëpunim me Policinë Bashkisë dhe Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit (IMT), nuk duhet të lejojë që në territorin e sajë të përdorin sipërfaqe pyjore/kullosore pa kontratë me bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja, mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë **Kryetarit të Bashkisë Has**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënie e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a -“Vërejtje” neni 58 shkronja (a), për 12 punonjës, si më poshtë:

1. Z. S. M., Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Taksave, në cilësinë e nëpunësit zbatues, - Për problemet e konstatuara në lidhje me mbledhjen e të ardhurave të bashkisë dhe monitorimin e borxhit, për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe paketën fiskale të miratuar VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021” .

-Për mangësitë e konstatuara në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në

njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, në lidhje me mbajtjen e librave të kontabilitetit, gjendjet e llogarive: 202 “*Studime dhe Kërkime*”, 423-429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*”, 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” dhe moskryerjen e inventarit fizik i aktiveve materiale dhe jo materiale si dhe aktiveve afatshkurtra të Bashkisë Has dhe 4 NJA-ve, Për këto aktive nuk është kryer inventar fizik për të verifikuar statusin e tyre, nëse ekzistojnë apo jo dhe marrjen e masave për ndjekjen e procedurave ligjore për sistemimin e tyre.

2. Z. U. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.

- Për problemet e konstatuara në lidhje me mbledhjen e të ardhurave të bashkisë dhe monitorimin e borxhit, për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe paketën fiskale të miratuar VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 “*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021*” .

- Mos monitorim të kontratave të qirasë dhe ndjekjen e debitorëve për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të qiradhënies në vlerën 1,207,337 lekë.

4. Z.Y. D. me detyrë inspektor i pronave.

Për mangësitë e konstatuara në kundërshtim me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*”, Kreu IV “*Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike*” nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “*Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike*” dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 “*Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)*” me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “*Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*” dhe me kontratat përkatëse pika 4 “*dispozita të veçanta*”, neni “*Pagesa*” ose “*Të drejtat dhe detyrimet e përdoruesit*”, me VKM nr.559, datë 29.07.2022 “*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore*” i ndryshuar, për:

- Mos kryerje të procedurave për transferimin përfundimtar të pronave për 3 NJA Golaj, Fajza dhe Gjinaj, duke mos kryer përditësimin e listave paraprake të inventarëve pronave të kaluara nga Pushteti Qendror me VKM Bashkisë dhe NJA-ve dhe mos hipotekimi i pasurive të paluajtshme të transferuara.

- Mos monitorim të kontratave të qirasë dhe ndjekjen e debitorëve për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të qiradhënies në vlerën 1,207,337 lekë.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për **4 ish-punonjësit** e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënie dhe zbatimin e tyre.

1. Z. L. M. në funksionin e ish- Kryetarit të Bashkisë Has

2. Z. F. Th. me detyrë ish zv/Kryetar i Bashkisë Has

3. Z. P. C. me detyrë ish-Drejtori i Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave

4. Z. H. B. me detyrë auditues në Sektorin e Auditit të Brendshëm

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHITIT